

RAPORT STUDIMOR

**ZBATIMI I LEGJISLACIONIT PËR
MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE NGA PARTITË
KRYESORE POLITIKE**

Tiranë, Tetor 2024



Të gjitha të drejtat për këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga WFD.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban.

Autor
Av. Franc Terihati

Tabela e Përmbajtjes

Lista e Shkurtimeve.....	4
Përmbledhje Ekzekutive.....	5
1. Metodologjia.....	6
2. Analizë e legjislacionit vendas lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga partitë politike	9
2.1. Detyrimi i regjistrimit të anëtarëve	9
2.2. Përpunimi i të dhënave personale për qëllime të fushatës zgjedhore	10
2.3. Informimi i subjektit të të dhënave (Të dhënat që përpunohen, vullnetare apo detyrim ligjor, të drejtat, etj.).....	12
2.4. Bllokimi, korigjimi ose fshirja e të dhënave	13
2.5. Hartimi i rregullores për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale	13
2.6. Përpunimi i të dhënave nëpërmjet faqes zyrtare në internet.....	13
2.7. Publikimi i fotove nga aktivitetet në rrjetet sociale.....	14
2.8. Përpunimi i të dhënave nëpërmjet mbikëqyrjes me “imazhe”, “video” dhe “audio”.....	14
2.9. Delegimi i përpunimit të dhënave te të tretët.....	14
2.10. Detyrimet për subjektet përpunues të mëdhenj	14
2.11. Detyrimet për subjektet përpunuese të vogla.....	15
2.12. Roli i KDIMDP	15
2.13. Legjislacioni penal për zgjedhjet	15
3. Analizë e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga partitë politike.....	16
4. Analizë e legjislacionit për përpunimin e të dhënave personale nga partitë politike bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare	23
4.1. Analiza e GDPR për mbrojtjen e të dhënave personale lidhur me veprimtarinë e partive politike ...	23
4.2. Standardet mbrojtës së të dhënave personale me karakter politik sipas jurisprudencës së GJEDNJ.....	23
5. Analiza e legjislacionit të Mbretërisë së Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (MB) për mbrojtjen e të dhënave personale lidhur me veprimtarinë e partive politike.....	24
6. Analizë e legjislacionit të Kosovës për mbrojtjen e të dhënave personale në kontekstin e veprimtarisë së partive politike.	25
7. Analizë e legjislacionit të Kroacisë për mbrojtjen e të dhënave personale në kontekstin e veprimtarisë së partive politike.	26
8. Tabelë konkluzionesh krahasimore	26
9. Rekomandime për partitë politike në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.	28
10. Rekomandime për përmirësimin e legjislacionit dhe veprimtarisë së organeve publike lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga partitë politike.	29
11. Metodologji për shoqërinë civile për monitorimin e veprimtarisë së partive politike në kuadër të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.	30
12. Bibliografia	32
Aneks 1: Matrica Krahasuese	34
Aneks 2 – Analizë e plotë e legjislacionit vendas lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga partitë politike.....	36

Lista e Shkurtimeve

KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
PD	Partia Demokratike
PL	Partia e Lirisë
PS	Partia Socialiste
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
GDPR ¹	Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave
SMSI	Krijimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Sigurisë së Informacionit për Mbrojtjen e të dhënave
MB	Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut

¹ General Data Protection Regulation

Përmbledhje Ekzekutive

E drejta për jetë private dhe familjare, si një nga të drejtat themelore të njeriut, mbrohet në mënyrë të qartë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, veçanërisht në nenin 35, i cili garanton mbrojtjen e të dhënave personale dhe ndalon ndërhyrjet në jetën private pa bazë ligjore e cila shtrihet jo vetëm në sferën fizike të privatësisë, por edhe në atë digjitale, duke marrë parasysh zhvillimet teknologjike. Një mbrojtje e ngjashme sigurohet edhe nga neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e cila mbron individët nga ndërhyrjet arbitrare të shtetit në jetën private dhe familjare.

Partitë politike nga ndjekja e procedurave për themelimin dhe regjistrimin në gjykatë dhe në vijim gjatë veprimtarisë së tyre, përpunojnë të dhënat personale të anëtarëve të tyre.

Gjithashtu, partitë politike përpunojnë të dhënat e qytetarëve, të cilët janë regjistruar në listën e zgjedhësve për qëllime të fushatës zgjedhore. Përpunimi i të dhënave personale të zgjedhësve gjatë fushatës zgjedhore në përputhje me kriteret dhe parimet e mbrojtjes së të dhënave të përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar të fushës, është thelbësor jo vetëm për të garantuar të drejtën e privatësisë, por edhe për garantimin e ushtrimit të një të drejte tjetër kushtetuese, siç është e drejta e votës².

Përveç rasteve të mësipërme, partitë politike mund të përpunojnë gjatë veprimtarisë së tyre të dhëna personale për shkak të:

- Kontaktit nga qytetarët nëpërmjet faqes zyrtare në internet.
- Marrëdhënieve të punësimit.
- Zhvillimi i takimeve elektorale, trajnimeve, konsultimeve, tubimeve me anëtarë dhe simpatizantë.
- Prodhimi dhe shpërndarja e spoteve për promovimin e programeve elektorale dhe/ose thirrjen e qytetarëve për të votuar.
- Marrëdhënieve kontraktore me palë të treta.
- Monitorimit të ambienteve fizike nëpërmjet sistemeve të videosurvejimit, etj.

Përpunimi i të dhënave personale nga partitë politike si rregull duhet të realizohet në bazë të dhënies së pëlqimit nga subjekti i të dhënave dhe në rastet e tjera kur kjo e drejtë i është njohur shprehimisht në ligj. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale mund të realizohet aq kohë sa është e nevojshme bazuar në qëllimin për të cilin janë mbledhur, duke zbatuar masa sigurie për mbrojtjen e të dhënave dhe duke informuar subjektin e të dhënave për të drejtat e tij.

Nga hulumtimi studimor dhe informacioni i mbledhur nëpërmjet kërkesave për informacion dhe këqyrjes së faqeve zyrtare në internet, nëpërmjet të cilave partitë politike përpunojnë të dhëna personale, rezultoi që partitë politike nuk i përpunojnë të dhënat personale në përputhje me ligjin, duke mos informuar subjektin e të dhënave për llojin e të dhënave personale që përpunohen, qëllimin, mënyrën dhe kohëzgjatjen e përpunimit, mënyrën dhe kohën si mund të tërhiqet dhënia e pëlqimit, të drejtat e subjektit të dhënave për akses, të drejtën për fshirje dhe/ose korrigjim të të dhënave, emërtimin dhe kontaktin e kontrolluesit dhe të çdo pale të tretë që mund të përpunojë të dhëna personale për llogari të tij dhe masat organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale. Nga ana tjetër, rezultoi e pamundur të zhvillohej një analizë në tërësi e mënyrës së përpunimit të dhënave personale

² Faqe 9, Udhëzues për Përpunimin e të Dhënave Personale në Kontekstin e Fushatave Zgjedhore.

nga partitë politike, të cilat ishin në fokus të këtij raporti studimor, për shkak se nga ana tyre nuk u vendos në dispozicion informacioni i kërkuar lidhur me llojin e të dhënave personale që përpunohen prej tyre, procedurat dhe masat teknike dhe organizative që zbatohen për këtë qëllim.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) rezulton që në veprimtarinë e tij ka miratuar rregulla të përgjithshme gjithëpërfshirëse në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale të qytetarëve, të cilat gjejnë zbatim edhe në veprimtarinë e partive politike. Në rastin e përpunimit të dhënave personale të zgjedhësve gjatë fushatës zgjedhore, KDIMDP ka miratuar edhe një udhëzim³ dhe udhëzues⁴ përkatës. Përveç sa më sipër, do të vlerësohej si një nismë efektive miratimi nga KDIMDP i një udhëzuesi nëpërmjet të cilit të përcaktohen rregullat e posaçme që zbatohen për përpunimin e të dhënave nga partitë politike, ose përfshirja e këtyre të fundit në ligjin për partitë politike. Nga hetimet administrative të KDIMDP rezulton që partitë politike kanë përpunuar të dhëna personale duke mos respektuar dispozitat ligjore dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse. Aktualisht, rezulton që ende partitë politike përpunojnë të dhënat në faqet e tyre të internetit në kundërshtim me ligjin dhe si rrjedhojë është nevojshme që KDIMDP të zhvillojë hetime kryesisht për mbikëqyrur përmbushjen e rekomandimeve të caktuara prej tij.

Përsa i përket fushatave elektorale, ku ka më shumë përpunime të të dhënave personale, fushata e zgjedhjeve parlamentare të 25 prill 2021, u shoqërua me cenimin e të dhënave personale të shtetasve të Republikës së Shqipërisë dhe si rrjedhojë u disponuan masa administrative dhe rekomandime nga KDIMDP. Një procedim penal është duke u zhvilluar nga prokuroria dhe mbrojtja e të dhënave personale të zgjedhësve përbën dhe një ndër rekomandimet e OSBE/ODHIR. Bazuar në kontekstin e mësipërm dhe faktin që tashmë keqpërdorimi i të dhënave personale nëpërmjet dërgimit të mesazheve të “shënjestruara” duke përdorur mjete të ndryshme të komunikimit për të ndikuar në bindjet politike të zgjedhësve mund të përbëjë ndër faktorët kryesorë që mund të ndikojë në rezultatin e zgjedhjeve, do të vlerësohej e nevojshme zhvillimi i hetimeve periodike nga KDIMDP përpara zhvillimit të zgjedhjeve dhe parashikimi në legjislacionin penal i përpunimit të dhënave personale në kundërshtim me ligjin për të ndikuar në mënyrën e votimit ose rezultatin e zgjedhjeve.

1. Metodologjia

Hartimi i studimit është realizuar nëpërmjet zhvillimit të hulumtimeve studimore (desk research) dhe mbledhjes së informacionit me metoda cilësore duke zhvilluar intervista të thelluara, kërkuar informacion nga autoritetet publike dhe partitë politike dhe shqyrtuar raste konkrete të përpunimit të të dhënave personale.

1. Hulumtimi studimor është realizuar nëpërmjet:

- zhvillimit të një analize gjithëpërfshirëse të legjislacionit vendas për të dhënat personale (ligjit dhe udhëzimeve të KDIMDP) dhe legjislacionit që rregullon veprimtarinë e partive politike:

³ Udhëzim i KDIMDP nr. 35, datë 07.05.2013 “Për përpunimin e të dhënave personale për qëllime të fushatës zgjedhore”: https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/udhezimi_nr_35_date_07052013.pdf

⁴ Udhëzues për Përpunimin e të Dhënave Personale në Kontekstin e Fushatave Zgjedhore: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Udhezues_Faqosur-4-prill.pdf

- analizës së praktikave më të mira të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në Ballkanin Perëndimor, në Bashkimin Evropian (BE) dhe në Britaninë e Madhe.
2. Intervistat e thelluara janë zhvilluar me 4 përfaqësues të partive politike, Partia Socialiste (PS), Partia Demokratike (PD) dhe Partia e Lirisë (PL), KDIMDP, 2 përfaqësues nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) , 3 përfaqësues të shoqërisë civile dhe 2 gazetarë, të cilët kanë njohuri lidhur me organizimin dhe veprimtarinë e partive politike.
 3. Mbledhja e informacionit, dokumentimi dhe analiza e tij është realizuar nëpërmjet:
 - paraqitjes së kërkesave për informacion në bazë të ligjit për të drejtën e informimit pranë KDIMDP, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorisë;
 - paraqitjes së kërkesave për informacion pranë partive politike;
 - këqyrjes së faqeve zyrtare në internet të partive politike.

Të dhënat e administruara nëpërmjet hulumtimit dhe metodave cilësore kanë shërbyer në vijim për hartimin e raportit studimor, i cili është fokusuar në përmirësimin e legjislacionit për përpunimin e të dhënave personale nga partitë politike dhe përmbushjen prej tyre të detyrimeve që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Raporti studimor synon të shërbejë edhe si një udhëzues për shoqërinë civile për monitorimin e veprimtarisë së partive politike në kuadër të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në fund një matricë vlerësimi me tre partitë kryesore është realizuar për të parë zbatimin e ligjit prej tyre dhe me rekomandimet përkatëse për secilën parti.

Analiza e legjislacionit vendas

- i. Analiza e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- ii. Analiza e projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i publikuar për konsultim në vitin 2022.
- iii. Analiza e vendimit të KDIMDP nr.2, datë 10.3.2010 “Për përcaktimin e procedurave të administrimit të regjistrimit të të dhënave, hedhjes së të dhënave, përpunimit dhe nxjerrjes së tyre”, i ndryshuar.
- iv. Analiza e vendimit të KDIMDP nr. 4, datë 27.12.2012 “Për përcaktimin e rasteve për përjashtimet nga detyrimi për njoftimin e të dhënave personale që përpunohen”.
- v. Analiza e vendimit të KDIMDP nr. 6, datë 05.08.2013 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”.
- vi. Analiza e udhëzimit të KDIMDP nr. 35, datë 07.05.2013 “Për përpunimin e të dhënave personale për qëllime të fushatës zgjedhore”.
- vii. Analiza e udhëzimit të KDIMDP nr. 24, datë 27.12.2012 “Për detyrimet e kontrolluesve përpara se të përpunojnë të dhënat personale”.
- viii. Analiza e udhëzimit të KDIMDP nr. 3 datë 05.03.2010 “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e videosurvejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar.
- ix. Analiza e udhëzimit të KDIMDP nr. 22, datë 24.09.2012 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë të të dhënave personale nga subjektet përpunuese të vogla”.
- x. Analiza e udhëzimit të KDIMDP nr. 47, datë 14.09.2018 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë të të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”.

- xi. Analiza e udhëzimit të KDIMDP nr. 19, datë 03.08.2012 Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi, i ndryshuar.
- xii. Analiza e udhëzuesve të KDIMDP të publikuara në zbatim të udhëzimeve të mësipërme.
- xiii. Analiza e ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar.
- xiv. Analiza e ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- xv. Analiza e rekomandimeve të OSBE/ODHIR lidhur me zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

A. Analiza e legjislacionit të huaj

- i. Analiza e Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) për mbrojtjen e të dhënave personale lidhur me veprimtarinë e partive politike.
- ii. Analiza e legjislacionit të një shteti të Ballkanit Perëndimor për mbrojtjen e të dhënave personale lidhur me veprimtarinë e partive politike.
- iii. Analiza e legjislacionit të Mbretërisë së Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (MB) për mbrojtjen e të dhënave personale lidhur me veprimtarinë e partive politike.
- iv. Analiza e jurisprudencës së Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ).

B. Mbledhja e informacionit nëpërmjet intervistave të thelluara

Zhvillimi i katër intervistave të thelluara me përfaqësues të tre partive politike, tre intervistave të thelluara me përfaqësues të organizatave jofitimprurëse, dy intervistave të thelluara me gazetarë/akademikë, zhvillimi i dy intervistave të thelluara përfaqësues të KQZ dhe një interviste të thelluar me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pranë KDIMDP.

- i. Hartimi i një raporti me përfundimet e intervistave të thelluara.

C. Mbledhja e informacionit nga autoritetet publike dhe partitë politike

- i. Hartimi dhe paraqitja e kërkesave për marrjen e informacionit publik të mëposhtëm pranë KDIMDP:
 - Nëse ka parti politike të cilat kanë njoftuar KDIMDP për përpunimin e të dhënave personale dhe kanë depozituar rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale dhe kodin e etikës.
 - Nëse ka parti politike të cilat kanë njoftuar KDIMDP për delegimin e përpunimit të dhënave personale te subjekte të treta.
- ii. Këqyrja e faqes zyrtare në internet të KDIMDP për të identifikuar nëse ka vendime ose rekomandime ndaj partive politike lidhur me përpunimin e të dhënave personale.
- iii. Hartimi dhe paraqitja e kërkesave për marrjen e informacionit të mëposhtëm pranë 3 partive politike, PD, PL dhe PS:
 - Çfarë të dhënash personale përpunohen prej tyre?
 - Çfarë të dhënash personale sensitive përpunohen prej tyre?
 - A kanë miratuar rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, kodin e etikës dhe masa të tjera tekniko-organizative për mbrojtjen e të dhënave personale?
 - Në rast se po, vendosjen në dispozicion të rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, kodit të etikës dhe informacionit për masat të tjera tekniko-organizative për mbrojtjen e të dhënave personale

- A kanë deleguar te subjekte të treta përpunimin e të dhënave personale dhe kanë administruar dokumentacionin e nevojshëm për këtë qëllim?
- iv. Këqyrja e faqes zyrtare në internet të 3 partive politike, PD, PL dhe PS dhe verifikimi nëse përmbajnë politika të privatësisë.
- v. Analiza dhe vlerësimi nëse politikat e privatësisë të partive politike (në rastet kur janë publikuar) janë në përputhje me legjislacionin për të dhënat personale;
- vi. Hartimi dhe paraqitja e kërkesave për marrjen e informacionit publik në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm nëse gjatë pesë viteve të fundit janë zhvilluar procedime penale për çështje penale të lidhura me përpunimin e të dhënave personale nga partitë politike dhe çfarë është vendosur.
- vii. Hartimi dhe paraqitja e kërkesave për marrjen e informacionit publik në Këshillin e Lartë Gjyqësor nëse gjatë pesë viteve të fundit janë disponuar vendime nga gjykatat e shkallëve të para, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë për çështje penale të lidhura me përpunimin e të dhënave personale nga partitë politike.

2. Analizë e legjislacionit vendas lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga partitë politike

2.1. Detyrimi i regjistrimit të anëtarëve

Partitë politike janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit⁵. Partitë politike e fitojnë personalitetin juridik nëpërmjet vendimit të gjykatës nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë. Partia politike për t'u regjistruar në gjykatë dhe për të fituar personalitet juridik, duhet të depozitojë në sekretarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë kërkesë të nënshkruar nga jo më pak se 3 000 anëtarë themelues.

Kërkesa e mësipërme për regjistrimin e një partie politike duhet të përmbajë për çdo anëtar themelues: a) emrin dhe mbiemrin; b) numrin personal; c) vendbanimin⁶.

Informacioni i mësipërm, i cili përpunohet nga partia politike për anëtarët e saj themelues përbën të dhënë personale⁷ dhe gëzon mbrojtje nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Gjithashtu, informacioni për mendimet politike të një individi përbën të dhënë sensitive⁸ dhe në këtë mënyrë rezulton që partitë politike përpunojnë edhe të dhëna sensitive për anëtarët e tyre.

Si rregull, përpunimi i të dhënave personale sensitive është i ndaluar, ndërkohë që ligji ka parashikuar edhe disa raste përjashtimore kur mund të përpunohen këto të dhëna. Të

⁵ Neni 1 i ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar.

⁶ Nenet 9 dhe 10 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar.

⁷ Neni 3 pika 1 i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar parashikon që: "Të dhëna personale" është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

⁸ Neni 3 pika 4 i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar parashikon që: "Të dhëna sensitive" është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.

dhënat sensitive mund të përpunohen nga partitë politike, për qëllime të veprimtarisë të tyre të ligjshme, vetëm për anëtarët, sponsorizuesit ose personat e tjerë, që kanë lidhje me veprimtarinë e tyre. Këto të dhëna nuk u bëhen të ditura palëve të treta, pa pëlqimin e subjektit të të dhënave, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj⁹.

Mbas regjistrimit të themelimit të partisë politike, pranimi i anëtarëve të rinj mund të realizohet duke përpunuar të njëjtat të dhëna si për anëtarët themelues (emrin dhe mbiemrin, numrin personal dhe vendbanimin). Në nenin 14 të ligjit nr. 8580/2000 “Për partitë politike”, të ndryshuar, ligjvënësi ka përcaktuar në mënyrë të qartë se, të njëjtat rregulla ligjore të cilat përcaktohen për regjistrimin për së pari të një partie politike, ndiqen dhe janë njëjloj të vlefshme për ndryshimet dhe fshirjet në regjistrimet e mëparshme, në rastin kur organet apo forumet e partisë politike bëjnë ndryshime statutores, ndryshojnë, shfuqizojnë apo krijojnë rregulla të reja organizimi apo funksionimi, ndryshojnë emërtimet apo organet drejtuese të tyre¹⁰.

Pranimi i anëtarëve themelues dhe pranimi i anëtarëve të rinj duhet të realizohet duke shprehur subjekti i të dhënave pëlqimin e tij të qartë, të kuptueshëm dhe në formë të shkruar për përpunimin e të dhënave të tij sensitive, pasi të jetë informuar në mënyrë të plotë dhe të kuptueshme për qëllimin e përpunimit të këtyre të dhënave¹¹. Partitë politike duhet të mbajnë informacione të sakta, të plota dhe të përditësuara lidhur me të gjitha të dhënat personale të regjistruara për anëtarët sipas përcaktimeve në nenin 10 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” dhe ky informacion duhet të mbahet në mënyrë të kujdeseshme, duke u zbatuar të gjitha masat teknike dhe organizative për përpunimin e tij në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale¹².

2.2. Përpunimi i të dhënave personale për qëllime të fushatës zgjedhore

Ndarja ose kombinimi i paautorizuar i të dhënave personale të votuesve për qëllimet e supozuara të angazhimit demokratik mund të konsiderohet shkelje e angazhimit për mbrojtjen e të drejtës për jetën private dhe familjare¹³.

Gjatë fushatës zgjedhore çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të bëjë propaganda zgjedhore në çdo mënyrë të ligjshme¹⁴.

Përpunimi i të dhënave personale të zgjedhësve, legjitimohet, kur kjo kryhet në dy mënyra:

- *nëse zgjedhësi ka dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave, ose*
- *në rastin e parashikuar nga Kodi Zgjedhor.*

Kur baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale është pëlqimi, ai duhet të jetë i dhënë lirisht, për një qëllim specifik, i informuar dhe i qartë, duke pasur gjithashtu mundësinë e revokimit të tij në çdo moment.

Kur subjektet zgjedhore mbështeten te “*parashikimi ligjor*” në nenin 60 pika 1 i ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” për përpunimin e të

⁹ Neni 7 pika 2.e i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar

¹⁰ Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr. 00 - 2023 - 5377 i Vendimit (786) datë 27.12.2023, pika 31.

¹¹ Pika III.3, Vendim Nr.2, datë 10.3.2010 Për “Përcaktimin e Procedurave të Administrimit të Regjistrimit të të Dhënave, të Hedhjes së të Dhënave, të Përpunimit dhe Nxjerrjes së tyre”.

¹² Pika I.2, Vendim Nr.2, datë 10.3.2010 Për “Përcaktimin e Procedurave të Administrimit të Regjistrimit të të Dhënave, të Hedhjes së të Dhënave, të Përpunimit dhe Nxjerrjes së tyre”.

¹³ Paragrafi 24 i Dokumentit të OSBE-së të Moskës të vitit 1991; Faqe 19, Raporti Përfundimtar i Misionit të Kufizuar të ODHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare, 25 prill 2021.

¹⁴ Neni 78 pika 1 i ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

dhënave personale të mbledhura nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe/ose Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në çdo rast kjo arsye legjitime duhet t'u bëhet e njohur zgjedhësve¹⁵.

Çdo kandidat i regjistruar pranë KQZ i cili do të përpunojë të dhëna personale të zgjedhësve për qëllime të fushatës zgjedhore, detyrohet:

- t'i mbledhë të dhënat personale drejtpërdrejtë nga zgjedhësit,
- duke siguruar që këta të fundit janë informuar për:
 - a. qëllimin e mbledhjes së të dhënave dhe
 - b. për mënyrën e përdorimit të tyre¹⁶.

a) Përpunimi i të dhënave personale nëpërmjet pëlqimit të zgjedhësit.

Nëse kandidati përpunon të dhëna personale si: detajet e pikëpamjeve politike, mendimeve, apo ndonjë tregues të synimeve të votimit si dhe në rast se i përdor të dhënat personale të mbledhura drejtpërdrejt nga zgjedhësit për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë¹⁷, atëherë duhet të:

- merret paraprakisht pëlqimi nga zgjedhësi. Pëlqimi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) është dhënë me shkrim; b) mban datën dhe nënshkrimin; c) është dhënë lirisht pas marrjes së informacionit të detajuar në lidhje me natyrën, rëndësinë, efektet, etj; ç) është i dokumentuar¹⁸

- merren masa mbrojtëse shtesë për të mbrojtur këtë informacion dhe të dhënat personale sensitive shkatërrohen në mënyrë të sigurt.
- të vendoset në dispozicion për komunikim një numër telefoni pa pagesë, në të cilin zgjedhësit mund të kërkojnë në mënyrë të thjeshtë ndalimin e tregtimit të drejtpërdrejtë.

Në rast se kandidati përpunon të dhënat personale të mbledhura drejtpërdrejtë nga zgjedhësit për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë nëpërmjet subjekteve të treta, duhet të lidhet kontrata e përpunimit (outsourcing) bazuar në Udhëzimin Nr. 19, datë 03.08.2012. Zgjedhësit kanë të drejtë në çdo kohë të kërkojnë nga kandidati ndalimin e përpunimit të të dhënave sensitive dhe tregtimit të drejtpërdrejtë¹⁹.

b) Përpunimi i të dhënave personale në rastin e parashikuar nga Kodi Zgjedhor.

Listat e zgjedhësve dhe ekstraktet e përbërësve zgjedhorë vihen në dispozicion të subjekteve zgjedhore ose, sipas rastit, partive politike, me kërkesën e tyre dhe pa pagesë, nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe/ose Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Subjektet zgjedhore të regjistruara në KQZ ose partitë politike, me kërkesën

¹⁵ Faqe 10, Udhëzues për Përpunimin e të Dhënave Personale në Kontekstin e Fushatave Zgjedhore.

¹⁶ Neni 3.1, udhëzim Nr. 35, datë 07 .05. 2013 Per "Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime të Fushatës Zgjedhore".

¹⁷Faqja 1, shembull që thjeshton zbatimin e udhëzimit Nr. 35, datë 07 .05. 2013 Për "Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime të Fushatës Zgjedhore" (...) tregtimi i drejtpërdrejtë nuk është vetëm shitja e mallrave dhe shërbimeve, por përfshin gjithashtu promovimin e qëllimeve dhe idealeve të cdo organizate duke përfshirë edhe partitë politike (nëpërmjet dërgimit të mesazheve me faks, sms, email). I tillë është inkurajimi i individëve që të votojnë për një parti apo kandidat të veçantë. Tregtimi përfshin komunikimin "drejtuar një individ të veçantë" (...).

¹⁸ Neni 2.5 dhe 6.1, udhëzim Nr. 35 , datë 07 .05. 2013 Per "Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime Të Fushatës Zgjedhore.

¹⁹ Neni 6, udhëzim Nr. 35 , datë 07 .05. 2013 Per "Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime Të Fushatës Zgjedhore"

e tyre dhe pa pagesë, mund të marrin nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile një kopje elektronike të listave të zgjedhësve ose ekstraktit të përbërësve zgjedhorë në shkallë vendi, si dhe sa herë që ato përditësohen dhe publikohen. Kopja elektronike hartohet në mënyrë të tillë që të lejojë kërkime dhe krahasime të kryqëzuara të të dhënave²⁰. Kandidati mund të përdorë të dhënat personale të mbledhura nga lista e zgjedhësve në Regjistrin Kombëtar Elektronik të Gjendjes Civile, vetëm për qëllime që lidhen me zgjedhjet²¹.

Të dhënat e marra nga këto lista zyrtare të zgjedhësve nuk duhen kombinuar me burime të tjera të dhënash personale, me qëllim krijimin e profileve të zgjedhësve nëpërmjet shënjestrimit.²² Sa më sipër, mundëson që subjektet zgjedhore të “profilizojnë” zgjedhësit me saktësi gjithnjë e më të lartë e të dërgojnë mesazhe të “shënjestruara” nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit duke ndikuar në bindjet e tyre politike²³.

Në rast se kandidati delegon përpunimin e listës zgjedhore të subjekte, të treta në këtë rast duhet të lidhet kontrata e përpunimit (outsourcing) dhe Udhëzimi i KDIMDP Nr. 19, datë 03.08.2012 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes Kontrolluesit dhe Përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”.

Pavarësisht se KDIMDP ka miratuar vendimin Nr. 4, datë 27.12.2012 “Për përcaktimin e rasteve për përjashtimet nga detyrimi për njoftimin e të dhënave personale që përpunohen”, nëpërmjet të cilit parashikon që kontrolluesi nuk është i detyruar të njoftojë KDIMDP kur përpunimi i të dhënave personale kryhet nga partitë politike, për qëllime të veprimtarisë së tyre të ligjshme, për anëtarët, sponsorizuesit ose personat e tjerë, që kanë lidhje të vazhdueshme me veprimtarinë e këtyre organizatave, në rastet kur kandidati përpunon të dhëna personale për qëllime të fushatës zgjedhore në mënyrë manuale si dhe duke përdorur pajisje elektronike, të tilla si kompjuter, email, faks, sms, ai është i detyruar të njoftojë paraprakisht KDIMDP²⁴.

Në rast se kandidati rezulton fitues në zgjedhje, ai do të vijojë të jetë i regjistruar në regjistrin e KDIMDP për aq kohë sa ai qëndron në detyrë, ndërkohë që KQZ detyrohet të paraqesë pranë KDIMDP listën e kandidatëve fitues dhe humbës të zgjedhjeve elektorale, në mënyrë që ky i fundit të kryejë fshirjen e regjistrimit nga regjistri të kandidatëve jo fitues në zgjedhjet elektorale²⁵.

2.3. Informimi i subjektit të të dhënave (Të dhënat që përpunohen, vullnetare apo detyrim ligjor, të drejtat, etj.).

Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij.

²⁰ Neni 60 pika 1 i ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

²¹ Neni 3, udhëzim Nr. 35 , datë 07 .05. 2013 Per “Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime Të Fushatës Zgjedhore”

²² Faqe 11, Udhëzues Për Përpunimin e të Dhënave Personale në Kontekstin e Fushatave Zgjedhore.

²³ Faqe 5, Udhëzues Për Përpunimin e të Dhënave Personale në Kontekstin e Fushatave Zgjedhore.

²⁴ Neni 5.1, udhëzim Nr. 35 , datë 07 .05. 2013 Për “Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime të Fushatës Zgjedhore”

²⁵ Neni 5.1 dhe 5.2, udhëzim Nr. 35 , datë 07 .05. 2013 Për “Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime të Fushatës Zgjedhore”

Kontrolluesi është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare. Nëse subjekti i të dhënave, në bazë të një akti ligjor ose nënligjor, është i detyruar të japë të dhëna personale për përpunim, kontrolluesi e informon edhe rreth këtij fakti, si dhe rreth pasojave të refuzimit të dhënies së të dhënave personale²⁶.

2.4. Bllokimi, korrigjimi ose fshirja e të dhënave

Kontrolluesi duhet të kryejë edhe kryesisht bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, kur vëren se janë të parregullta, të pavërteta, të paplota ose janë përpunuar në kundërshtim me ligjin²⁷.

Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, pa pagesë, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me ligjin dhe kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e bllokimit, korrigjimit apo të fshirjes²⁸.

2.5. Hartimi i rregullores për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale

Partitë politike duhet të miratojnë *“Rregullore për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori të dhënash), sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, nivelet e aksesit etj., sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar dhe Vendimin nr. 6, datë 05.08.2013 të Komisionerit *“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”*²⁹.

Partitë politike nuk janë të detyruar të njoftojnë KDIMDP kur përpunimi i të dhënave personale kryhet për qëllime të veprimtarisë së tyre të ligjshme, për anëtarët, sponsorizuesit ose personat e tjerë, që kanë lidhje të vazhdueshme me veprimtarinë e këtyre organizatave.

2.6. Përpunimi i të dhënave nëpërmjet faqes zyrtare në internet

Çdo parti politike që përpunon të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare të tij, ka detyrimin që të publikojë *“Politikat e Privatësisë”*, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me kontrolluesin realizohet përmes faqes online të internetit. Në këtë kuadër, publikimi i rubrikës *“Politikat e Privatësisë”* në faqen zyrtare të kontrolluesit, duhet të përmbushë qëllimin e informimit përkundrejt subjekteve të të dhënave, të cilët aksesojnë dhe ngarkojnë të dhëna personale në faqe. Njëkohësisht, informimi sipas përcaktimeve të nenit 18 të ligjit duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale, në rast se kontrolluesi përpunon të dhëna personale, të marra drejtpërdrejtë nga subjekti i të dhënave³⁰.

²⁶ Neni 18 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar.

²⁷ Neni 19 pika 1 i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar.

²⁸ Neni 13 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar.

²⁹ Vendim Nr. 27, datë 13.6.2023 PËR KONTROLLUESIN “ELTON ZHULEKU” Person Fizik. Vendim Nr. 03, datë 15.02.2023 PËR KONTROLLUESIN “INSIG” SHA, pika 7.

³⁰ Vendim Nr. 20 datë 18.05.2023 Për Kontrolluesin “Real Deal SH.P.K.” pika 2.

2.7. Publikimi i fotove nga aktivitetet në rrjetet sociale

Në rastet kur kontrolluesi pasqyron në llogaritë e biznesit të krijuara prej tij në rrjetet sociale (Facebook, Instagram, Twitter, etj.) aktivitete nëpërmjet publikimit të fotografive dhe videove të individëve, kontrolluesi duhet të kryejë marrjen e pëlqimit paraprak ndaj subjektit të të dhënave për publikimin e fotografive/videove në rrjetet sociale që administron, në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të ligjit³¹.

Dhënia e këtij “Pëlqimi” duhet të plotësojë kërkesat e ligjit, konkretisht duhet garantuar në formë shkresore, i dhënë shprehimisht, me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen përse të dhënat do të përpunohen³².

2.8. Përpunimi i të dhënave nëpërmjet mbikëqyrjes me “imazhe”, “video” dhe “audio”

Përpunimi i të dhënave me anë të një sistemi video survejimi mund të lejohet vetëm nëse qëllimi për të cilin është instaluar ky sistem nuk mund të arrihet në një mënyrë tjetër. Instalimi i një sistemi video survejimi është i ndaluar në rrugë kalimi, trotuar, jashtë ambientit të zyrës dhe në dhoma që përdoren ekskluzivisht për qëllime private si tualete, dushe, zhveshje³³.

Kontrolluesi duhet të parashikojë rregulla/politika lidhur me mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit CCTV dhe të marrë masa teknike-organizative, në mënyrë që të mbrohen sistemet e regjistrimit, mënyrat e transferimit dhe mjetet transmetuese në të cilin gjenden regjistrimet duke i mbrojtur nga akseset e paautorizuara apo aksidentale, ndryshimi, shkatërrimi, humbja ose përpunimi i paautorizuar, si dhe të sigurojë ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave³⁴.

2.9. Delegimi i përpunimit të dhënave të tretët

Në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave nëpërmjet një subjekti të tretë kontrolluesi duhet të miratojë një kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të përpunuesit të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi³⁵. Kontrata e përpunimit (outsourcing) është akti në bazë të së cilit kontrolluesi i kërkon përpunuesit të kryejë për llogari të tij një pjesë të përpunimit të të dhënave personale.³⁶

2.10. Detyrimet për subjektet përpunues të mëdhenj

Legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale ka parashikuar detyrime të posaçme për subjektet të cilët angazhojnë 6 ose më shumë persona për përpunimin e të dhënave. Këta të fundit quhen Subjekt Përpunues i Madh dhe duhet të përmbushin detyrimet në vijim: *Krijimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Sigurisë së Informacionit për*

³¹ Vendim Nr. 08, datë 17.03.2023 Për Kontrolluesin “Canadian Kindergarten Tirana – KJL&CO SHPK”, pika 2

³² Vendim Nr. 08, Datë 17.03.2023 Për Kontrolluesin “Canadian Kindergarten Tirana – KJL&CO SHPK”, pika 4.

³³ Pika 4.a Udhezim Nr. 3 Datë 05/03/2010 Mbi “Përpunimin e të Dhënave Personale me Sistemin e Video Survejimit në Ndërtesa dhe Mjedisë të Tjera”.

³⁴ Pika 4. ç Udhezim Nr. 3 Datë 05/03/2010 Mbi “Përpunimin e të Dhënave Personale me Sistemin e Video Survejimit në Ndërtesa dhe Mjedisë të Tjera”. Vendim Nr. 12, Datë 26.07.2024 Për Kontrolluesin “Qendra e Zhvillimit të Fëmijëve me Aftësi Ndryshe”, Bashkia Lushnjë, Pika 4.

³⁵ Vendim Nr. 01, datë 17.01.2023 Për Kontrolluesin “Toronto Group” SHPK, pika 2.

³⁶ Pika 10, udhëzimi nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, i ndryshuar.

Mbrojtjen e të dhënave (SMSI)³⁷. Analiza e Ndikimit të të Dhënave Personale³⁸. Politika e Sigurisë dhe Informacionit. Kontrolli i Sigurisë së Informacionit. Trajnimi i personelit³⁹. Caktimi i personit të kontaktit⁴⁰.

2.11. Detyrimet për subjektet përpunuese të vogla

Subjekte përpunuese të vogla janë kontrolluesit ose përpunuesit të cilët përpunojnë të dhëna personale në mënyrë elektronike ose manuale, duke shfrytëzuar më pak se 6 persona⁴¹ dhe duhet të plotësojnë detyrimet në vijim: *Analizën e riskut⁴². Sigurinë fizike dhe të ambientit⁴³. Sigurinë logjike të pajisjeve TIK të përpunimit të të dhënave personale⁴⁴. Sigurinë e personelit⁴⁵.*

2.12. Roli i KDIMDP

KDIMDP është organi publik kryesor i ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe marrjen e masave për parandalimin e cenimit të tyre. KDIMDP, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve kryen kontrollimin e përpunimit të të dhënave, në përputhje me ligjin, si dhe verifikimin nëse procesi është i ligjshëm. Në rastet kur konstaton përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale ai urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullimin. Në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit:

- Vendos masën e dënimit me gjobë në rastet kur shkelja përbën kundërvajtje administrative⁴⁶.
- Denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.
- Paraqet kallëzim penal kur shkelja përbën vepër penale⁴⁷.

2.13. Legjislacioni penal për zgjedhjet

Aktualisht, veprat penale në fushën e zgjedhjeve lidhen me korrupsionin aktiv dhe pasiv, dëmtimi i materialeve zgjedhore, shkelja e fshehtësisë në votim, votimi më shumë se një herë, etj, sipas neneve 325 - 332/a të kreut X "Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve" të Kodit Penal.

Përpunimi në kundërshtim me ligjin e të dhënave personale për qëllime elektorale nuk gëzon një mbrojtje të veçantë nga ligji penal dhe në këtë rast do të zbatoheshin eventualisht

³⁷ Pika nr.8, udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit "Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha"

³⁸ Pika nr.11.a, udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit "Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha"

³⁹ Pika nr.24, udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit "Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha"

⁴⁰ Pika nr.27, udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit "Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha"

⁴¹ Pika 2, Udhëzim Nr. 22, Datë 24.09.2012 Per "Përcaktimin e Rregullave për Ruajtjen e Sigurisë të të Dhënave Personale të Përpunuara nga *Subjektet Përpunuese të Vogla 1*"

⁴² Pika 8.a, Udhëzim Nr. 22, Datë 24.09.2012 Për "Përcaktimin e Rregullave për Ruajtjen e Sigurisë të të Dhënave Personale të Përpunuara nga *Subjektet Përpunuese të Vogla*".

⁴³ Pika 8.b, Udhëzim Nr. 22, Datë 24.09.2012 Për "Përcaktimin e Rregullave për Ruajtjen e Sigurisë të të Dhënave Personale të Përpunuara nga *Subjektet Përpunuese të Vogla*".

⁴⁴ Pika 8.c, Udhëzim Nr. 22, Datë 24.09.2012 PËR "Përcaktimin e Rregullave për Ruajtjen e Sigurisë të të Dhënave Personale të Përpunuara nga *Subjektet Përpunuese të Vogla*".

⁴⁵ Pika 8. ç, Udhëzim Nr. 22, Datë 24.09.2012 Për "Përcaktimin e Rregullave për Ruajtjen e Sigurisë të të Dhënave Personale të Përpunuara nga *Subjektet Përpunuese të Vogla*"

⁴⁶ Neni 39 i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

⁴⁷ Neni 30 i i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

dispozitat penale të përgjithshme si: përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike (neni 293/a i Kodit Penal), ndërhyrja në të dhënat ose sistemet kompjuterike (Nenet 293/b dhe 293/c të Kodit Penal), keqpërdorimi i pajisjeve (neni 293/ç i Kodit Penal), hyrja e paautorizuar kompjuterike (neni 192/b i Kodit Penal), mashtrimi kompjuterik (143/b i Kodit Penal), etj.

Në bazë të neneve 281 dhe 283 të Kodit të Procedurës Penale, procedimi penal mund të fillojë në bazë të kallëzimit penal i cili është i detyrueshëm të paraqitet nga nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, marrin dijeni për një vepër penale ose nga çdo person që ka marrë dijeni për një vepër penale dhe është i detyruar ta kallëzojë atë. Në përputhje me sa më sipër, ligji për mbrojtjen e të dhënave personale⁴⁸ ka parashikuar që KDIMDP bën kallëzimin përkatës për rastet që shkelja përbën vepër penale.

3. Analizë e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga partitë politike.

Në intervistën e thelluar të realizuar me përfaqësuesin e PD⁴⁹ u parashtrua se ky subjekt politik në rastet e zhvillimit të zgjedhjeve njihet me listat e zgjedhësve dhe ekstraktet e përbërësve zgjedhorë në përputhje me nenin 60 pika 1 të ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të dhënat e marra nga këto lista zyrtare të zgjedhësve nuk kombinohen me burime të tjera të dhënash personale dhe mbas zhvillimit të zgjedhjeve kryen asgjësimin e tyre në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, nga ana e tij u parashtrua se PD ka të përditësuar listën e anëtarëve dhe personat të cilët përpunojnë të dhëna personale janë të trajnuar, kanë nënshkruar deklarata konfidencialiteti dhe kanë nivele të ndryshme aksesit, duke njohur aq të dhëna personale sa është e nevojshme në përputhje me detyrat e tyre funksionale dhe qëllimin e përpunimit të tyre.

Në intervistën e thelluar të realizuar me përfaqësuesit e PS u parashtrua se në rastet kur qytetarët anëtarësohen pranë PS dhe kur përpunohen të dhëna personale për qëllime të fushatës zgjedhore, ky subjekt politik zbaton të gjitha detyrimet ligjore të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në intervistën e thelluar të realizuar me Drejtoreshën e Ankesave dhe Harmonizimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u vendos në dispozicion informacion lidhur me hetimet administrative të zhvilluara nga ky institucion për përhapjen e paligjshme të të dhënave personale të shtetasve në vitin 2021 dhe vendimin dhe rekomandimet që u disponuan lidhur me këtë rast. Gjithashtu, përfaqësuesja e KDIMDP informoi lidhur me veprimtarinë e këtij institucioni me fokus mbrojtjen e të dhënave personale të mbledhura për qëllime të fushatës zgjedhore nëpërmjet miratimit të Udhëzimit Nr. 35, datë 07 .05. 2013 “Për Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime të Fushatës Zgjedhore” dhe Udhëzuesit “Për Përpunimin e të Dhënave Personale në Kontekstin e Fushatave Zgjedhore, ndërkohë që për raste të tjera të përpunimit të të dhënave personale zbatohet ligji, vendimet dhe udhëzimet e KDIMDP.

Në intervistat e thelluara të realizuara me përfaqësues të organizatave jofitimprurëse, gazetarë dhe akademikë u parashtrua nevoja për të forcuar mekanizmat ligjore dhe

⁴⁸ Neni 30. 2/1 i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

⁴⁹ Nga PD intervista e thelluar u zhvillua me Z. Marash Logu.

institucionale për të garantuar transparencë në përpunimin e të dhënave personale nga partitë politike nëpërmjet listës së zgjedhësve dhe parandalimi i kombinimit të këtyre të dhënave me të dhëna të cilat përpunohen për qëllime të tjera. Përfaqësuesit e Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve dhe Institutit të Studimeve Politike theksuan nevojën për miratimin e një legjislacioni të posacëm për mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara nga partitë politike, në mënyrë që të rezultojnë në mënyrë të qartë dhe të qendërzuara detyrimet që rëndojnë mbi këto subjekte. Gjithashtu, këta dy të intervistuar theksuan nevojën e parashikimit të mekanizmave ligjore për të garantuar transparencë lidhur me mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të të anëtarëve të partive politike.

Në intervistën e thelluar të realizuar me përfaqësuesin e Qëndresa Qytetare u parashtrua se kjo organizatë jofitimprurëse ka paraqitur pranë KDIMDP ankesë duke kërkuar ndër të tjera konstatimin e paligjshmërisë në përpunimin e të dhënave personale nga aplikacioni “Aktiv1st”, krijuar PS dhe dënimin e këtij subjektit me gjobë dhe me detyrimin për të fshirë të dhënat personale të mbledhura dhe të përpunuara në kundërshtim me ligjin, dhe lidhur me këtë ankesë nuk ka marr një përgjigje. KDIMDP informoi që i ka kthyer përgjigje Qëndresa Qytetare nëpërmjet shkresës nr. 307/1 prot. datë 17.03.2023. Gjithashtu, përfaqësuesit e organizatave jofitimprurëse theksuan nevojën që KDIMDP të ndërmarrë hetime administrative kryesisht në mënyrë periodike ndaj subjekteve politike dhe në raste kur konstatohen shkelje të ligjit, të rënda ose të përsëritura KDIMDP të mos mjaftohet me dhënien e rekomandimeve por të zbatojë masat administrative përkatëse

Në intervistën e thelluar të realizuar me Drejtoreshën e Drejtorisë së Ligjshmërisë në KQZ dhe stafin e saj mbështetës u vendos në dispozicion informacion lidhur me llojin e të dhënave personale që përpunohen nga ky organ publik në cilësinë e kontrolluesit dhe mungesa e kompetencave ligjore dhe njëherësh edhe e informacionit lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga partitë politike.


Për të zhvilluar një analizë të plotë dhe të gjithanshme të përpunimit të dhënave personale nga partitë politike, në kuadër të metodologjisë së zbatuar për hartimin e këtij raporti studimor, u paraqitën kërkesa për marrjen e informacionit të mëposhtëm pranë 3 partive politike, PD, PL dhe PS:

- Çfarë të dhënash personale përpunohen prej tyre?
- Çfarë të dhënash personale sensitive përpunohen prej tyre?
- A kanë miratuar rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, kodin e etikës dhe masa të tjera tekniko-organizative për mbrojtjen e të dhënave personale?
- Në rast se po, vendosjen në dispozicion të rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, kodit të etikës dhe informacionit për masat të tjera tekniko-organizative për mbrojtjen e të dhënave personale.
- A kanë deleguar te subjekte të treta përpunimin e të dhënave personale dhe kanë administruar dokumentacionin e nevojshëm për këtë qëllim?


Deri në datën e hartimit të raportit studimor, PD, PL dhe PS nuk vendosën në dispozicion informacionin e kërkuar lidhur me llojin e të dhënave personale që përpunohen prej tyre, nëse kanë miratuar rregullore dhe masa të tjera tekniko-organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, nëse konsiderohen përpunues të mëdhenj ose të vegjël, etj.

Gjithashtu, u zhvillua këqyrja e faqeve zyrtare të internet të 3 partive politike, PD, PL dhe PS, për të analizuar nëse këto subjekte politike përpunojnë të dhëna personale nëpërmjet këtyre faqeve dhe nëse përmbajnë rregulla të plota për mbrojtjen e të dhënave personale.

- i. PD në faqen <https://pd.al>⁵⁰ ka vendosur një hapësirë të emërtuar “Angazhohu tani”, e cila kur e shtyp hap faqen <https://pd.al/kontakt/>. Nëpërmjet kësaj faqe qytetarëve i jepet mundësia të kontaktojnë PD duke dërguar të dhënat personale si vijon: emër, mbiemër, adresë email, numër telefoni dhe adresën e banimit.



Në fund të kësaj faqe janë vendosur Politikat e Privatësisë. Duke shtypur Politikat e Privatësisë hapet një faqe në gjuhën angleze e cila përmban informacione lidhur me cookies dhe përpunimin e të dhënave personale.



9. Your rights with respect to personal data

You have the following rights with respect to your personal data:

- You have the right to know why your personal data is needed, what will happen to it, and how long it will be retained for.
- Right of access: You have the right to access your personal data that is known to us.
- Right to rectification: you have the right to supplement, correct, have deleted or blocked your personal data whenever you wish.
- If you give us your consent to process your data, you have the right to revoke that consent and to have your personal data deleted.
- Right to transfer your data: you have the right to request all your personal data from the controller and transfer it in its entirety to another controller.
- Right to object: you may object to the processing of your data. We comply with this, unless there are justified grounds for processing.

To exercise these rights, please contact us. Please refer to the contact details at the bottom of this Cookie Policy. If you have a complaint about how we handle your data, we would like to hear from you, but you also have the right to submit a complaint to the supervisory authority (the Data Protection Authority).

10. Contact details

For questions and/or comments about our Cookie Policy and this statement, please contact us by using the following contact details:

Partia Demokratike e Shqipërisë
Bulevardi Zhan D'Ark, 1001, Tiranë
Albania
Website: <https://pd.al>
Email: info@pd.al

This Cookie Policy was synchronized with cookieatabase.org on 01/11/2022.

Lidhur me përpunimin e të dhënave personale, rezulton që subjektet e të dhënave informohen për:


⁵⁰ Këqyrja e faqes web <https://pd.al> u realizua në datën 11.09.2024 në intervalin kohor 12.42 deri 12.48.

- Të drejtën për akses, të drejtën për të kërkuar bllokimin, korrëgjimin ose fshirjen, të drejtën për të revokuar pëlqimin e dhënë për të përpunuar të dhëna personale, të drejtën për të transferuar të dhënat, të drejtën për të kundërshtuar.
- Emërtimin e kontrolluesit dhe të dhënat e tij të kontaktit.

Nga sa më sipër rezulton që Politikat e privatësisë nuk janë publikuar në gjuhën shqipe dhe nuk informojnë për llojin e të dhënave personale që përpunohen, qëllimin, mënyrën dhe kohëzgjatjen e përpunimit, nëse dhënat personale përpunohen në bazë të pëlqimit apo detyrimi ligjor, masat organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale.

Nuk parashikohet mundësia e subjektit të të dhënave për dhënien e pëlqimit në formë shkresore, shprehimisht dhe me vullnet të plotë e të lirë për përpunimin e të dhënave personale. Subjekti i të dhënave nuk njihet me qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrëgjim dhe fshirje, etj.).

- ii. PL në faqen zyrtare në internet <https://partiaelirise.al>⁵¹ ka vendosur një hapësirë të emërtuar “Kontakt” , e cila kur e shtyp hap faqen <https://partiaelirise.al/kontakt/> . Nëpërmjet kësaj faqe qytetarëve i jepet mundësia të kontaktojnë Partinë e Lirisë duke dërguar të dhënat personale si vijon: emër, mbiemër dhe adresë email.



Kontakt

Emri / Mbiemri

Emaili Juaj

Subjekti Juaj

Mesazhi Juaj

DERGO

Zyrat Qëndrore
Rr. Sami Frasheri, Godina 20/10, Tirane
Tel: +35544504178
Email: info@partiaelirise.al

Gjithashtu, PL në faqen zyrtare në internet <https://partiaelirise.al> ka vendosur një hapësirë të emërtuar “Donacione”, e cila kur e shtyp hap faqen <https://partiaelirise.al/donacione/>. Në fund të kësaj faqe është vendosur shënimi: *“I vetëdijshëm që të dhënat e mia personale do të kontrollohen dhe përpunohen në respektim të Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, pasi mora dijeni, autorizoj subjektin për sa parashikohet në këtë ligj”*.

⁵¹ Këqyrja e faqes web <https://partiaelirise.al> u realizua në datën 11.09.2024 në intervalin kohor 13.18 deri 13.30.

partiaelise.al/donacione/

PARTIA E LIRISË Kreu Partia Alternativa Politike **PRIORITETET** Lajme Bashkohen me ne Kontakt f i t s **DONACIONE**

b. ushtron veprimtari në fushën e medias;
c. ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme;
ç. ka detyrime monetare ndaj Buxhetit ose ndaj çdo institucioni publik.

Ky detyrim nuk zbatohet nëse aksionari i zotëron këto aksione si rezultat i ofertës publike.

- Personat fizikë ose personat juridikë, që i kanë bërë dhurime një subjekti zgjedhor apo kandidatëve të tij në zgjedhje, nuk mund të përfittojnë për periudhën deri 3 vjet pas datës së zgjedhjeve kontrata publike, kontrata të partneritetit publik privat ose në çdo mënyrë tjetër fonde me vlerën totale që tejkalon shumën prej 10 milionë lekësh, përfshirë edhe si nënkontraktues të një kontrate/koncesioni publik.
- Subjekti zgjedhor është i detyruar të bëjë publike dhe të sigurojë akses të plotë e të pandërprerë të të tretëve në bazën e të dhënave, ku subjekti zgjedhor regjistron dhurimet, huatë ose kreditë e përfuata nga ai dhe kandidatët e tij, për të gjitha vlerat e barabarta dhe më të larta se 50 mijë lekë.

MËNYRAT E PAGESËS

PAGESA ONLINE OSE PARAQITUNI PRANË DEGËS BANKARE MË TË AFËRT

SWIFT I CREDINS BANK CDISALTRXXX
NUMRI I LLOGARISË AL80 2121 1009 0000 0000 0010 5129

Ju lutemi shkarkoni deklaratën e konfliktit të interesit, firmoseni dhe dërgojeni përsëri.

No file chosen Jap Pëlqimin Nuk jap Pëlqimin

I vetëdëshëm që të dhënat e mia personale do të kontrollohen dhe përpunohen në respektim të Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, pasi mora dijeni, autorizoj subjektin për sa parashikohet në këtë ligj.


Nga sa më sipër rezulton që PL nuk ka publikuar Politika të Privatësisë në gjuhën shqipe, të cilat të informojnë për llojin e të dhënave personale që përpunohen, qëllimin, mënyrën dhe kohëzgjatjen e përpunimit, mënyrën dhe kohën si mund të tërhiqet dhënia e pëlqimit, të drejtat e subjektit të të dhënave për akses, të drejtën për fshirje dhe/ose korigjim të të dhënave, emërtimin dhe kontaktin e kontrolluesit dhe të çdo pale të tretë që mund të përpunojë të dhëna personale për llogari të tij dhe masat organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale.

Subjekti i të dhënave nuk njihet nga PL me qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korigjim dhe fshirje, etj.).

- iii. PS në faqen zyrtare në internet <https://ps.al>⁵² ka vendosur një hapësirë të emërtuar "Anëtarësohu", e cila kur e shtyp hap faqen <https://register.ps.al/>. Nëpërmjet kësaj faqe qytetarëve i jepet mundësia të plotësojnë "Formular Anëtarësimi" duke dërguar të dhënat personale si vijon: emër, mbiemër, atësia, mëmësia, vendlindja, datëlindja, numër personal ID, data e skadimit të kartës, gjinia, viti i anëtarësimit, të dhëna lidhur me arsimimin, të dhëna lidhur me punësimin, numri i celularit, adresë email, linku i adresës Facebook, linku i adresës Twitter, adresa e plotë e banimit, Qarku, Bashkia, Njësia Administrative dhe numri i Qendrës së Votimit.


Lidhur me përpunimin e të dhënave personale, rezulton që subjektet e të dhënave për të dërguar formularin e plotësuar me të dhënat e mësipërme duhet të plotësojnë kutinë: *"Dakordësoj për përdorimin e të dhënave personale": Duke u regjistruar në platformën e anëtarësisë ju jeni dakord me Kushtet e përdorimit, dhe ju jepni pëlqimin/miratimin tuaj për përdorimin e të dhënave personale, të cilat do të përpunohen në përputhje të plotë me përcaktimet e Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të ndryshuar, aktet nënligjore të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe legjislacionin Shqiptar në fuqi.*

⁵² Këqyrja e faqes web <https://ps.al> u realizua në datën 11.09.2024 në intervalin kohor 12.26 deri 13.09.



Gjithashtu, PS në faqen zyrtare në internet <https://ps.al> ka vendosur një hapësirë të emërtuar “Aplikacioni”, e cila kur e shtyp hap faqen <https://apps.apple.com/us/app/aktiv1st/id1601972495> (Aktiv1st).

Për të aksesuar këtë aplikacion është e nevojshme që të krijohet një llogari duke regjistruar të dhënat: emër, mbiemër, adresë email dhe fjalëkalimi.



Nga sa më sipër, rezulton që PS nuk ka publikuar Politika të Privatësisë në gjuhën shqipe, të cilat të informojnë për llojin e të dhënave personale që përpunohen, qëllimin, mënyrën dhe kohëzgjatjen e përpunimit, mënyrën dhe kohën si mund të tërhiqet dhënia e pëlqimit, të drejtat e subjektit të dhënave për akses, të drejtën për fshirje dhe/ose korrigjim të të dhënave, emërtimin dhe kontaktin e kontrolluesit dhe të çdo pale të tretë që mund të përpunojë të dhëna personale për llogari të tij, dhe masat organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale.

Subjekti i të dhënave nuk njihet nga PS me qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje, etj.).

Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga kontrolluesi mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Informimi sipas përcaktimeve të nenit 18 të ligjit, duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, që kryen kontrolluesi⁵³.

PS⁵⁴ dhe PD⁵⁵ kanë qenë objekt hetimi administrativ nga KDIMDP edhe në vitin 2014. Në përfundim të hetimeve administrative KDIMDP ka disponuar dy rekomandime nëpërmjet të cilave ndër të tjera rekomandon dy partitë politike të publikojnë në faqet e tyre në internet në një rubrikë të veçantë me politikën e privatësisë, me qëllim informimin e subjekteve të të

⁵³ Vendim Nr. 08, datë 03.05.2024 Për Kontrolluesin “Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare Tiranë”, pika 4.

⁵⁴Rekomandim i KDIMDP nr. 12 datë 27.02.2014.

⁵⁵ Rekomandim i KDIMDP nr. 13 datë 27.02.2014.

dhënave personale, si dhe të përfshihen kushtet, kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. KDIMDP i ka caktuar partive politike afat 30 ditor për përmbushjen e këtyre detyrimeve.

Gjithashtu, në vitin 2021 PS ka qenë sërish objekt hetimi administrativ dhe KDIMDP ka rekomanduar⁵⁶ këtë subjekt politik ndër të tjera të ndalojë përdorimin e rubrikës “rekomando shokun tënd” të aksesueshme në faqen e internetit www.ps.al deri në marrjen e masave të nevojshme për informimin e subjekteve të të dhënave dhe marrjen e pëlqimit të tyre në përputhje me ligjin.

- iv. Gjatë fushatës së Zgjedhjeve Parlamentare të datës 25 prill 2021, përmes një rrjedhjeje informacioni, në domeinin publik doli një databazë me informacione personale dhe detaje kontakti për afërsisht 900,000 qytetarë shqiptarë, që përmbante edhe preferencat e tyre potenciale të votimit⁵⁷.

KDIMDP zhvilloi hetime administrative të cilat u publikuan në “Relacionin e hetimit administrativ për përhapjen e paligjshme të të dhënave personale të shtetasve”, nr. 1399 prot., datë 19.08.2021. Në përfundim të kësaj veprimtarie, KDIMDP u shpreh me 3 Rekomandime dhe me 1 Vendim, që korrespondon me një sanksion administrativ. Për të gjithë kontrolluesit e përfshirë në këto hetime administrative, Zyra e Komisionerit nxiti për marrjen e masave për: hartimin e strategjisë për SMSI, ngritjen e strukturave monitoruese për SMSI, trajnimin e vazhdueshëm të stafit, projektimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të sigurisë së rrjetit dhe enkriptimi i të dhënave gjatë transferimit të tyre, zbatimin e politikave për kontrolle dhe kufizimin e përdoruesve sipas nevojave për punë, si dhe auditimin periodik të sistemeve, etj⁵⁸.

Lidhur me procedimet penale të regjistruara dhe ndjekura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për çështje të përpunimit të dhënave personale nga partitë politike gjatë 5 viteve të fundit, ka rezultuar se më datë 26.10.2021 është regjistruar procedimin penal nr. 7681, për veprën penale “Hyrja e paautorizuar kompjuterike”, parashikuar nga neni 192/b i Kodi Penal. Rreth kësaj çështje (që njihet ndryshe edhe si databaza e patronazhistëve) janë nisur kryesisht hetimet nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe më datë 30.09.2021 aktet kanë kaluar Prokurorisë së Tiranës, pas shpalljes së moskompetencës. Çështja aktualisht është ende në fazën e hetimeve paraprake pa emër autori të regjistruar. Hetimet në lidhje me këtë fakt penal vazhdojnë dhe informacion më i hollësishëm për veprimet konkrete në këtë fazë nuk mund t’u jepet për arsye të respektimit të sekretit hetimor⁵⁹.

- v. Në lidhje me rastin kur kandidati përpunon të dhëna personale për qëllime të fushatës zgjedhore në mënyrë manuale si dhe duke përdorur pajisje elektronike, të tilla si kompjuter, email, faks, sms, u kërkua pranë KDIMDP informacioni i mëposhtëm:

1. Nëse ka pasur raste kur kandidatë/parti politike kanë njoftuar KDIMDP dhe cilat janë këto raste?

⁵⁶ Rekomandim i KDIMDP nr. 44 datë 19.08.2024.

⁵⁷ Faqe 19, Raporti Përfundimtar i Misionit të Kufizuar të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare, 25 prill 2021.

⁵⁸ Faqe 23-25 Raporti Vjetor 2021 KDIMDP dhe Kthim përgjigje kërkesës për informacion KDIMDP datë 10.09.2024.

⁵⁹ Kthim përgjigje kërkesës për informacion Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e datës 18.09.2024

2. Nëse KQZ ka paraqitur pranë KDIMDP listën e kandidatëve fitues dhe humbës të zgjedhjeve elektorale?
3. Nëse KDIMDP ka kryer fshirjen e regjistrimit nga regjistri të kandidatëve jo fitues në zgjedhjet elektorale?

Nga informacioni i përcjellë nga zyra e KDIMDP rezulton që nuk ka pasur raste kur kandidatët kanë njoftuar KDIMDP për përpunimin e të dhënave personale për qëllime të fushatës zgjedhore në mënyrë manuale si dhe duke përdorur pajisje elektronike, të tilla si kompjuter, email, faks, sms.

4. Analizë e legjislacionit për përpunimin e të dhënave personale nga partitë politike bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare

4.1. Analiza e GDPR për mbrojtjen e të dhënave personale lidhur me veprimtarinë e partive politike

GDPR ndër të tjera rregullon mënyrën se si organizatat, përfshirë partitë politike, mbledhin, përpunojnë dhe ruajnë të dhënat personale të qytetarëve të BE-së. Neni 9.2 (d) lejon përpunimin e të dhënave kur kryhet nga një parti politike për anëtarët ose personat që kanë kontakte të rregullta me të, me kusht që të dhënat të mos shpërndahen jashtë organizatës pa pëlqimin e subjektit të të dhënave. Neni 9.2 (e) lejon përpunimin e të dhënave të bëra publike nga subjekti, dhe neni 9.2 (g) lejon përpunimin për arsye të rëndësishme publike, sipas ligjit të BE-së apo shteteve anëtare.

Çdo komunikim në një fushatë politike duhet të kryhet nga një përfaqësues i cili prezantohet në mënyrë të qartë dhe është i përgatitur për t'u përgjigjur pyetjeve rreth arsyes së mbledhjes së të dhënave, përdorimit të tyre, ndarjes me palët e treta dhe mënyrës se si votuesi mund të tërheqë pëlqimin. Këto tekste informuese duhet të jenë të disponueshme publikisht në faqen e internetit të fushatës. Në kontekstin e reklamave digjitale politike, partitë politike gjatë fushatës duhet t'u ofrojnë votuesve informacion të mjaftueshëm se pse po shohin një mesazh të caktuar, kush është përgjegjës për të, dhe si mund të ushtrojnë të drejtat e tyre për të parandaluar shënjestrimin.

Një nga aspektet më të rëndësishme të GDPR është mbrojtja e individëve nga përpunimi i të dhënave për qëllime tregtimi të drejtpërdrejtë. Sipas GDPR, tregtimi i drejtpërdrejtë është i lejuar vetëm nëse qytetari ka dhënë pëlqimin e tij të qartë ose nëse përmbushet një interes i ligjshëm i përpunuesit që nuk bie ndesh me të drejtat e individit⁶⁰ dhe dhe ata kanë mundësi të heqin dorë nga ky përpunim në çdo kohë. Në rastet kur partitë politike përdorin të dhënat e individëve për të krijuar profile dhe për të personalizuar mesazhet e tyre, GDPR kërkon që ky proces të jetë transparent dhe që individët të informohen për mënyrën se si përpunohen të dhënat e tyre për këtë qëllim⁶¹.

4.2. Standardet mbrojtës së të dhënave personale me karakter politik sipas jurisprudencës së GJEDNJ

KEDNJ, nën nenin 8, garanton të drejtën për privatësi, ndërsa Konventa Nr. 108+ e Këshillit të Evropës vendos standarde për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë ato të përpunuara në kontekste politike. Sipas nenit 6 të Konventës 108+, të dhënat personale që zbulojnë origjinën racore, opinionet politike, besime fetare ose të tjera, dhe informacion mbi shëndetin

⁶⁰ Neni 6, GDPR

⁶¹ Neni 4 (11) dhe neni 22 i GDPR.

ose jetën seksuale të një individi, ose dënimet penale, nuk mund të përpunohen automatikisht, përveç nëse ligji vendos parashikon të përshtatshme masat mbrojtëse. Informacioni që i përket këtyre kategorive, të përshkruara nga Gjykata si “sensitive”, garanton një shkallë më të lartë mbrojtje.

Në çështjen *Catt kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ gjeti shkelje të nenit 8 të KEDNJ për shkak të mungesës së masave mbrojtëse për të siguruar fshirjen e të dhënave personale të një protestuesi paqësor, të cilat zbulonin opinionet e tij politike. Mbajtja e këtyre të dhënave nga policia u bë joproporcionale pasi ato nuk ishin më të rëndësishme për qëllimin e ruajtjes së tyre. Gjykata theksoi se të dhënat sensitive, që përfshijnë bindjet politike, kërkojnë mbrojtje të veçantë dhe fshirje të tyre kur bëhen të panevojshme. Në mungesë të një rregulloreje që përcaktonte periudhën maksimale të ruajtjes së të dhënave, aplikanti varej plotësisht nga autoritetet për zbatimin e garancive të përcaktuara në kodin e praktikës, i cili ishte tepër fleksibël. Gjykata konstatoi se garancia për fshirjen e të dhënave kishte një efekt të kufizuar, pasi autoritetet refuzuan të fshinin të dhënat ose të jepnin arsye për ruajtjen e tyre, edhe pas një kërkesë nga subjekti i të dhënave⁶².

Në çështjen *Segerstedt-Wiberg dhe të tjerët kundër Suedisë (2006)*, GJEDNJ konstatoi se ruajtja e të dhënave personale të vjetra në dosjet e shërbimeve të sigurimit, lidhur me pjesëmarrjen e ankuesve në takime politike dhe mbrojtjen e rezistencës së dhunshme ndaj policisë, ishte një shkelje e Nenit 8 të KEDNJ. Gjykata vlerësoi se interesi i shtetit për mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe luftën kundër terrorizmit duhet të balancohej me respektimin e jetës private të individëve. Edhe pse justifikimi për ruajtjen e këtyre të dhënave ishte fillimisht legjitim, vjetërsia e informacionit, rreth 30 vite, bëri që ndërhyrja të mos ishte më proporcionale. Ky rast nënvizon se ruajtja afatgjatë e të dhënave duhet të jetë e kufizuar dhe e justifikuar në bazë të nevojave aktuale dhe proporcionalitetit.

5. Analiza e legjislacionit të Mbretërisë së Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (MB) për mbrojtjen e të dhënave personale lidhur me veprimtarinë e partive politike.

MB është ndër vendet evropiane ku partitë politike lejohen të përdorin softuer për të mbledhur dhe përpunuar të dhëna personale të votuesve. Partitë politike në MB kanë të drejtën të shtojnë informacionet bazë nga lista zgjedhore me të dhëna personale shtesë për mbështetësit dhe kundërshtarët, të mbledhura nga burime të ndryshme⁶³.

GDPR është një rregullore e BE-së e cila nuk zbatohet më në MB, megjithatë dispozitat e GDPR të Bashkimit Evropian janë përfshirë drejtpërdrejt në ligjin e saj nëpërmjet Aktit të Mbrojtjes së të Dhënave 2018. Mes këtyre dy akteve ka pak ndryshime përveçse i përket parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave, të drejtave dhe detyrimeve⁶⁴.

Të gjitha partitë marrin të dhëna nga burimet e mëposhtme⁶⁵:

- Regjistri zgjedhor;

⁶² Catt kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikimi nr. 43514/15, 24 janar 2019.

⁶³ Colin J. Bennett, Smith Oduro-Marfo, Privacy, Voter Surveillance and Democratic Engagement: Challenges for Data Protection Authorities, <https://rm.coe.int/report-privacy-voter-surveillance-and-democratic-engagement-2774-4663-1680a10852>, aksesuar më datë 09.09.2024, fq. 35.

⁶⁴ Data Protection Act 2018, <https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2018/12/contents>, aksesuar më datë 11.09.2024.

⁶⁵ Po aty.

- Regjistri i shënuar (i cili është kopje e regjistrit zgjedhor që ka një shenjë nga emri i secilit zgjedhës që ka votuar);
- Direkt nga individët, zakonisht duke i pyetur ata personalisht ose përmes telefonit;
- Të dhënat e disponueshme publikisht dhe grupe të tjera të dhënash si të dhënat e regjistrimit, rezultati i zgjedhjeve, të dhënat e anketimit, të dhënat e banesave sociale dhe grupet e të dhënave të përpiluara nga qeveria ose agjenci të pavarura qeveritare.
- Gjithashtu ka dhe një burim tjetër i cili konsiston në informacionin mbi stilin e jetesës, i siguruar nga organizata të palëve të treta (të njohura si “ndërmjetësit e të dhënave”), ku disa parti politike kanë përdorur të dhëna nga këto organizata mundësuar përmes marrëveshjeve tregtare.

Ligji u lejon atyre të përdorin regjistrin zgjedhor për të kontaktuar dhe promovuar fushatat e tyre politike, përveç nëse janë të vetëdijshëm për kundërshtimin e individit ndaj tregtimit të drejtpërdrejtë.⁶⁶ Megjithatë, kjo nuk përjashton kërkesat për përpunim të drejtë sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave. Palët janë ende të detyruara t'u tregojnë individëve të cilëve u janë marrë të dhënat nga Regjistri Zgjedhor dhe për çfarë po i përdorin ato të dhëna⁶⁷.

6. Analizë e legjislacionit të Kosovës për mbrojtjen e të dhënave personale në kontekstin e veprimtarisë së partive politike.

Në Kosovë, mbrojtja e të dhënave personale, përfshirë ato të lidhura me veprimtarinë e partive politike, rregullohet nga ligji nr. 06/L-082 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i cili është harmonizuar me GDPR të Bashkimit Evropian dhe përcakton detyrimet për mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale. Agjencia për Informim dhe Privatësi e Kosovës si autoriteti kompetent për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka hartuar udhëzuesin për subjektet politike në vitin 2021: Komunikimi me Qytetarë Gjatë Fushatës Zgjedhore⁶⁸.

Sipas nenit 74 të ligjit nr. 06/L-082 ‘Për mbrojtjen e të dhënave personale’, individi (subjekti i të dhënave) ka të drejtë që në çdo kohë të kërkojë që kontrolluesit e të dhënave (në këtë rast partitë politike përmes operatorëve të telekomunikimit) të ndërpresin përdorimin e të dhënave personale të tij për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë. Veç kësaj, deputetët nuk duhet të shfrytëzojnë të dhënat e kontaktit të marra gjatë kryerjes së funksionit të tyre për tregtim të drejtpërdrejtë, përveç në rastet kur janë të sigurtë që zgjedhësit në fjalë do ta prisnin kontaktimin prej tyre dhe nuk do të kundërshtonin. Nëse një person shpreh dëshirën për të mos marrë informacione të tilla, partitë politike nuk kanë të drejtë të kontaktojnë individët përmes postës, postës elektronike, mesazheve, ose thirrjeve telefonike. Gjithashtu, nuk lejohet përdorimi i informacionit të tyre për profilizim ose për të identifikuar ata që duhet

⁶⁶ Zyra e Komisionerit të Informacionit, “Praktikat e fushatës politike: marketing direkt dhe online”, https://icosearch.ico.org.uk/s/search.html?query=political+campaign&collection=ico-meta&profile=_default, aksesuar më datë 09.09.2024.

⁶⁷ Zyra e Komisionerit të Informacionit, “Demokracia e ndërprerë? Informacioni personal dhe ndikimi politik” <https://ico.org.uk/media/action-ëeve-taken/2259369/democracy-disrupted-110718.pdf> 11 korrik 2018, fq.29, aksesuar më datë 09.09.2024

⁶⁸ Agjencia për Informim dhe Privatësi, Udhëzues për Subjektet Politike “Komunikimi me Qytetarë Gjatë Fushatës Zgjedhore”, <https://aip.rks-gov.net/download/komunikimi-me-qytetare-gjate-fushates-zgjedhore/?wpdmdl=6677&refresh=66f3d441f36a8172725561>, tetor 2021 fq. 3, aksesuar më datë 19.09.2024.

të kontaktohen për fushata marketingu. Këshillohet të mbahet një listë e individëve që kanë ushtruar këtë të drejtë në mënyrë që të sigurohet kështu dëshira e tyre.

Partitë politike kanë qasje të pakufizuar në regjistrin e plotë zgjedhor për qëllime elektorale, i cili përfshin kontaktimin e individëve të kësaj liste përmes postës. Duke e interpretuar këtë të drejtë më gjerësisht, ata mund të dërgojnë materiale të paadresuara promovuese përmes postës. Përdorimi i regjistrin për të kontaktuar individët për promovimin e një partie politike është legjitim, përveçse kur ata kanë shprehur dëshirën për të mos marrë informacione. Po ashtu, në rast të marrjes së të dhëna direkt nga individët, duhet që ata të informohen për përdorimin e tyre për tregtim të drejtpërdrejt⁶⁹.

Nëse një individ ofron adresën e postës elektronike në përgjigje ndaj një fletëpalosjeje të shpërndarë lidhur me një fushatë të caktuar dhe teksti i asaj fletëpalosjeje thotë qartë dhe në mënyrë të qartë se duke ofruar adresën e postës elektronike apo numrin e telefonit, ai person jep pëlqimin që ato të dhëna t'i përdoren në cilëndo fushatë aktuale dhe të ardhshme.

7. Analizë e legjislacionit të Kroacisë për mbrojtjen e të dhënave personale në kontekstin e veprimtarisë së partive politike.

Të dhënat që lidhen me opinionin politik përbëjnë një kategori të veçantë të të dhënave personale dhe përpunimi i tyre është përgjithësisht i ndaluar, përveç rasteve kur ekziston një bazë ligjore ose një nga përjashtimet e përcaktuara në nenin 9, paragrafi 2 të GDPR, siç është pëlqimi i qartë dhe specifik i subjektit të të dhënave për një ose më shumë qëllime të caktuara⁷⁰. Votuesit kanë të drejtë të kundërshtojnë përpunimin e të dhënave personale në çdo kohë, pavarësisht nëse kanë dhënë pëlqimin paraprak. Kjo përbën një të drejtë që duhet t'u komunikohet qartë votuesve në çdo mesazh marketingu. Në rast se një votues kundërshton, nuk mund të dërgohen më mesazhe të tilla. Gjithashtu, nëse subjekti i të dhënave kundërshton përpunimin për qëllime marketingu, të dhënat e tij nuk mund të përdoren më për këto qëllime⁷¹.

Në rastin e shënjestrimit të votuesve është thelbësore që votuesit të marrin informacion për shpjegimin e mesazhit që ata po marrin, identitetin e përgjegjësit për mesazhin dhe mënyrat për të ushtruar të drejtat e tyre, duke përfshirë të drejtën për të paraqitur ankesë. Çdo individ që beson se u janë shkelur të drejtat e tij të garantuara nga Rregullorja mund të paraqesë një ankesë për të verifikuar shkeljen e të drejtave të tij.

8. Tabelë konkluzionesh krahasimore

	Mbretëria e Bashkuar	Kroaci	Kosovë	Shqipëri
GDPR	Që prej largimit nga Bashkimi Evropian, MB ka miratuar një version të GDPR, të njohur si	Si vend anëtar i BE, Kroacia ka detyrimin e zbatimit të plotë të Rregullores.	Kosova ka miratuar ligjin nr. 06/L-082 "Për mbrojtjen e të dhënave	Shqipëria ka miratuar ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të

⁶⁹Agjencia për Informim dhe Privatësi, Udhëzues për Subjektet Politike "Komunikimi me Qytetarë Gjatë Fushatës Zgjedhore" <https://aip.rks.gov.net/download/komunikimi-me-qytetare-gjate-fushates-zgjedhore/?wpdmdl=6677&refresh=66f3d441f36a8172725561> Prishtinë, tetor 2021 fq.7, aksesuar më datë 22.09.2024

⁷⁰ Shih më sipër.

⁷¹ Agjencia Kroatë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "Rekomandime për përpunimin e të dhënave personale në prag të zgjedhjeve vendore 2021" <https://azop.hr/preporuke-za-obradu-osobnih-podataka-uoci-lokalnih-izbora-2021/> aksesuar më datë 23.09.2024.

	"MB GDPR", e cila ka ngjashmëri me origjinalin, por me disa rregullime.		personale" i cili është i përafuar me GDPR.	dhënave personale", i cili ligjërisht nuk rezulton të jetë rrjedhojë e përafritit me GDPR, por reflekton parimet e tij.
Teknologjia e përdorur për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale.	MB ka adoptuar teknika më të avancuara për mbledhjen dhe përpunimin e të dhëna personale të votuesve.	Përdorimi i programeve dhe inteligjencës artificiale për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave ka vend për përmirësim në fushën e teknologjive më të avancuara.	Përdorimi i teknologjive është më pak i përhapur në masë për shkak të burimeve të kufizuara për të investuar në teknologji të avancuara. Mbikëqyrje të dobët, ka nevojë për edukim dhe trajnim mbi përdorimin efektiv dhe etik të teknologjisë.	Përdorimi i teknologjive është më pak i përhapur në masë për shkak të burimeve të kufizuara për të investuar në teknologji të avancuara. Mbikëqyrje të dobët, ka nevojë për edukim dhe trajnim mbi përdorimin efektiv dhe etik të teknologjisë.
Organi kompetent për administrimin e regjistrimit zgjedhor	Zyra e Regjistrimit Zgjedhor ⁷²	Ministria e Drejtësisë, Administratës Publike dhe Transformimit Digjital	KQZ	KQZ
Burimet e mbledhjes së të dhënave	Çdo Zyrë e Regjistrimit Zgjedhor në nivel vendor mbledh të dhëna për votuesit. Qytetarëve u kërkohet të regjistrohen për të votuar dhe ky informacion përpilohet në Regjistrin Zgjedhor. Të dhënat mblidhen dhe përditësohen gjatë gjithë vitit përmes formularëve të regjistrimit në internet dhe në letër ⁷³ .	Të dhënat e votuesve menaxhohen nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (Državno izborno povjerenstvo). Dhe mblidhen prej Regjistrimit të Votuesve (Registar birača), i cili është i lidhur me sistemin e Numrit Personal të Identifikimit (OIB). Qytetarët shtohen automatikisht në regjister bazuar në vendbanimin e tyre dhe të dhënat personale të ruajtura në bazat e të	KQZ krijon dhe administron listën votuese në bazë të të dhënave të Regjistrimit Civil të Kosovës ⁷⁵ .	Në Shqipëri, të dhënat e zgjedhësve mblidhen dhe mirëmbahen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile e cila është në varësi të Ministrisë së Brendshme. Të dhënat merren nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i cili përmban informacione për qytetarët, si emri, data e lindjes dhe adresa, të cilat përdoren për hartimin e listave zgjedhore.

⁷² The electoral Commission, <https://www.electoralcommission.org.uk/running-electoral-registration-wales/your-role-and-responsibilities-electoral-registration-officer>, aksesuar më datë 19.09.2024.

⁷³ The Electoral Commission, Electoral Register <https://www.electoralcommission.org.uk/voting-and-elections/how-elections-work/electoral-register> aksesuar më datë 20.09.2024.

⁷⁵ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Lista votuese, <https://kqz-ks.org/sherbimet-per-votuesit/lista-votuese/> aksesuar më datë 20.09.2024.

		dhënave kombëtare ⁷⁴ .		
Pëlqimi i dhënë	Të gjitha legjislacionet e shteteve parashikojnë se qytetarët duhet të informohen në mënyrë të qartë, të kuptueshëm e të në mënyrë që pëlqimi i tyre të jetë i vullnetshëm dhe i lirë; si dhe të u ofrohet mundësia e refuzimit dhe tërheqje së pëlqimit të tyre në çdo kohë pa ndonjë pengesë. Pëlqimi duhet të dokumentohet në mënyrë që të provohet se është marrë në përputhje me ligjin.			

9. Rekomandime për partitë politike në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

- i. Gjatë përpunimit të dhënave personale, partitë politike duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme organizative dhe teknike për të mbrojtur dhe parandaluar përhapjen e tyre. Disa nga masat që duhet të merren janë: hartimi i rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, trajnimi dhe përcaktimi i niveleve të aksesit ndërmjet punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, punonjësit që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale duhet të nënshkruajnë deklaratë konfidencialiteti, të dhënat sensitive duhet të ruhen të ndara nga çdo e dhënë tjetër personale, duke vendosur rregulla të posaçme të mbrojtjes së tyre.
- ii. Partitë politike gjatë përpunimit të dhënave personale të zakonshme apo sensitive, duhet të informojnë subjektin e dhënave çfarë të dhënash përpunohen, nëse përpunimi i të dhënave është vullnetare apo buron nga një detyrim ligjor, mënyrën e përfitimit të të dhënave dhe përpunimit të tyre, kohëzgjatjen e përpunimit të të dhënave dhe çfarë të drejtash ka subjekti i të dhënave. Mbajtja e të dhënave duhet të udhëhiqet nga parimi i mjaftueshmërisë, sipas të cilit të dhënat personale mund të përpunohen vetëm për një periudhë të caktuar, aq sa është e nevojshme bazuar në qëllimin për të cilin janë mbledhur.
- iii. Partitë politike duhet t'i njohin subjekteve të të dhënave, përveç të drejtës për akses, të drejtën për të kërkuar bllokimin, korrigjimin dhe fshirjen e të dhënave personale.
- iv. Faqet zyrtare në internet të partive politike të cilat përbëjnë një ndër mundësitë për t'u kontaktuar nga qytetarët, gazetarët, apo mbështetësit e tyre dhe parashikojnë hapësirë nëpërmjet të cilave këta të fundit të përcjellin të dhënat e tyre personale (emër, mbiemër, adresë email, numër telefoni, etj.) pranë partive politike, duhet të përmbajnë politika të qarta privatësie. Politikat e privatësisë duhet të jenë publikuar në gjuhën shqipe, të informojnë për llojin e të dhënave personale që përpunohen, qëllimin, mënyrën dhe kohëzgjatjen e përpunimit, nëse dhënat personale përpunohen në bazë të pëlqimit apo detyrimi ligjor, mënyrën dhe kohën si mund të tërhiqet dhënia e pëlqimit, të drejtat e subjektit të dhënave për akses, të për fshirje dhe/ose korrigjim të të dhënave, për t'u ankuar dhe për kompensimin e dëmit, emërtimin dhe kontaktin e kontrolluesit dhe të çdo pale të tretë që mund të përpunojë të dhëna personale për llogari të tij, dhe masat organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale.
- v. Në rast të përpunimit të dhënave personale për qëllime të fushatës zgjedhore lidhur me pikëpamjet politike, apo ndonjë tregues të synimeve të votimit të zgjedhësve apo për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë, partia politike/kandidati duhet të marrë paraprakisht pëlqimin me shkrim të zgjedhësve, i cili duhet të mbajë datën dhe

⁷⁴Decision of the Croatian Parliament nr. 3073, datë 19.12.2012, [https://www.izbori.hr/site/UserDocs/Images/Zakoni%20-%20enql/Zakon o registru biraca NN 144-12 EN.pdf](https://www.izbori.hr/site/UserDocs/Images/Zakoni%20-%20enql/Zakon%20o%20regjistru%20biraca%20NN%20144-12%20EN.pdf), aksesuar më datë 20.09.2024.

nënshkrimin dhe të jetë dhënë lirisht pas marrjes së informacionit të detajuar në lidhje me natyrën, rëndësinë, efektet, etj. Partia politike/kandidati duhet të zbatojë masa mbrojtëse shtesë për të mbrojtur këtë informacion dhe të dhënat personale sensitive shkatërrohen në mënyrë të sigurt dhe gjithashtu të vendosë në dispozicion komunikim një numër telefoni pa pagesë, në të cilin zgjedhësit mund të kërkojnë në mënyrë të thjeshtë ndalimin e tregtimit të drejtpërdrejtë. Të dhënat personale të mbledhura nga lista e zgjedhësve në Regjistrin Kombëtar Elektronik të Gjendjes Civile, kandidati duhet t'i përdorë vetëm për qëllime që lidhen me zgjedhjet.

10. Rekomandime për përmirësimin e legjislacionit dhe veprimtarisë së organeve publike lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga partitë politike.

- i. Rekomandojmë që në legjislacionin penal të përfshihet një dispozitë nëpërmjet të cilës përpunimi i të dhënave personale në kundërshtim me ligjin për të ndikuar në mënyrën e votimit, ose për çdo qëllim tjetër të paligjshëm që lidhet me zgjedhjet. Aktualisht, veprat penale në fushën e zgjedhjeve lidhen me korrupsionin aktiv dhe pasiv, dëmtimi i materialeve zgjedhore, shkelja e fshehtësisë në votim, votimi më shumë se një herë, etj, dhe përpunimi në kundërshtim me ligjin i të dhënave personale për qëllime elektorale nuk gëzon një mbrojtje të veçantë nga ligji penal. Në rast të përpunimit të dhënave personale në kundërshtim me ligjin për të ndikuar në mënyrën e votimit, ose për çdo qëllim tjetër të paligjshëm që lidhet me zgjedhjet, në këtë rast do të zbatoheshin eventualisht dispozitat penale të përgjithshme si: përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike, ndërhyrja në të dhënat ose sistemet kompjuterike, keqpërdorimi i pajisjeve, hyrja e paautorizuar kompjuterike, mashtrimi kompjuterik, etj. Ky rekomandim propozohet duke pasur parasysh masën dhe pasojat e përhapjes së të dhënave personale në kuadër të zgjedhjeve të 25 prillit 2021 dhe faktin që nëpërmjet teknologjive të reja mbledhja, analiza dhe përdorimi i informacioneve të cilat përmbajnë të dhënat personale përbën ndër faktorët kryesorë që mund të ndikojë në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.
- ii. Miratimin nga KDIMDP të një udhëzuesi nëpërmjet të cilit të përcaktohen rregullat specifike që zbatohen për përpunimin e të dhënave nga partitë politike, ose përfshirja e këtyre të fundit në ligjin për partitë politike. Aktualisht, përpunimi i të dhënave personale nga partitë politike rregullohet nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, vendimet dhe udhëzimet e KDIMDP, ndërkohë që i vetmi udhëzues dhe udhëzim të cilët përmbajnë rregulla dhe udhëzime specifike për partitë politike lidhen me përpunimin e të dhënave personale për qëllime të fushatës zgjedhore. Nëpërmjet paraqitjes në mënyrë të plotë dhe shteruese të detyrimeve specifike të partive politike lidhur me përpunimin e të dhënave personale, nga njëra anë këto të fundit do të kishin mundësi të informohen në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qartë mbi detyrimet e posaçme që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale për to dhe nga ana tjetër do të fuqizoheshin kapacitetet e subjekteve të të dhënave dhe aktorëve të shoqërisë civile për të monitoruar partitë politike për përmbushjen e detyrimeve përkatëse.
- iii. Realizimin kryesisht nga KDIMDP të kontrolleve në mënyrë periodike të përpunimit të të dhënave nga partitë politike përpara zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore, si dhe verifikimin nëse procesi i përpunimit është i ligjshëm ose jo. Ky rekomandim buron nga problematikat që janë konstatuar në zgjedhjet e zhvilluara në Shqipëri ndër vite, veçanërisht në zgjedhjet e 25 prill 2021, ku për shkak të cenimit të dhënave personale

të shtetasve të Republikës së Shqipërisë u disponuan 3 Rekomandime dhe 1 Vendim nga KDIMDP dhe është regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë procedimi penal për veprën penale “Hyrja e paautorizuar kompjuterike”, parashikuar nga neni 192/b i Kodi Penal. Mbrojtja e të dhënave personale të zgjedhësve përbën dhe një ndër rekomandimet e OSBE/ODHIR⁷⁶ dhe kontrolli periodik dhe përpara zhvillimit të zgjedhjeve do të përbënte një mekanizëm thelbësor, jo vetëm në kuadër të mbrojtjes së të drejtës së privatësisë, por edhe garantimit të zgjedhjeve me votim të lirë, të fshehtë dhe të barabartë.

- iv. Ndërmarrja e hetimeve administrative më të shpeshta kryesisht nga KDIMDP, lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga partitë politike gjatë veprimtarisë së tyre (jo domosdoshmërisht të lidhur me fushatat zgjedhore). Zhvillimi i hetimeve administrative kryesisht paraqet rëndësi të veçantë në rastet kur KDIMDP i ka dhënë rekomandime partive politike për përbushjen e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale⁷⁷ dhe është thelbësore që KDIMDP të mbikëqyrë përbushjen prej kontrolluesve të rekomandimeve të caktuara prej tij. Gjithashtu, zhvillimit hetimeve kryesisht vlerësohet thelbësore në kushtet kur nuk ka patur raste kur kandidatët kanë njoftuar KDIMDP për përpunimin e të dhënave personale për qëllime të fushatës zgjedhore në mënyrë manuale si dhe duke përdorur pajisje elektronike, të tilla si kompjuter, email, faks, sms.

11. Metodologji për shoqërinë civile për monitorimin e veprimtarisë së partive politike në kuadër të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Treguesit për vlerësimin e realizimit	Po	Jo
Partia politike ka miratuar “Rregullore për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”.		
Subjekti i të dhënave është informuar nga partia politike për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat dhe për mënyrën e përpunimit.		
Partia politike ka kryer bllokimin, korigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, të parregullta, të pavërteta, të paplota ose që janë përpunuar në kundërshtim me ligjin.		
Gjatë fushatës zgjedhore partia politike/kandidati ka mbledhur të dhëna lidhur me pikëpamjet politike, mendimet, apo ndonjë tregues të synimeve të votimit mbasi është marr paraprakisht pëlqimi nga zgjedhësi.		
Gjatë fushatës zgjedhore partia politike/kandidati ka përdorur të dhënat personale të mbledhura nga lista e zgjedhësve në Regjistrin Kombëtar Elektronik të Gjendjes Civile, vetëm për qëllime që lidhen me zgjedhjet.		

⁷⁶ Faqe 19, Raporti Përfundimtar i Misionit të Kufizuar të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare, 25 prill 2021: “Shqipëria duhet të garantojë sigurinë e të dhënave personale të qytetarëve. Institucionet përkatëse duhet të hetojnë dhe të sanksionojnë plotësisht çdo shkelje që ndikon në besimin e publikut në procesin zgjedhor”.

⁷⁷ Për shembull në rastin e Rekomandimeve nr. 12 datë 27.02.2014, nr. 13 datë 27.02.2014 dhe nr. 44 datë 19.08.2024 të KDIMDP.

Partia politike/kandidati ka deleguar përpunimin e listës zgjedhore te subjekte të treta dhe ka lidhur kontratën e përpunimit (outsourcing) të dhënave personale.		
Partia politike përpunon të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare zyrtare në internet dhe ka publikuar “Politikat e Privatësisë”.		
“Politikat e Privatësisë” janë në gjuhën shqipe, të informojnë për llojin e të dhënave personale që përpunohen, qëllimin, mënyrën dhe kohëzgjatjen e përpunimit, të drejtat e subjektit të dhënave për akses, të drejtën për fshirje dhe/ose korrëgjim të të dhënave, emërtimin dhe kontaktin e kontrolluesit dhe të çdo pale të tretë që mund të përpunojë të dhëna personale për llogari të tij, dhe masat organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale.		
Partia politike ka marr pëlqimin e subjektit të të dhënave për publikimin e fotografive dhe videove të tij në rrjetet sociale.		
Dhënia e pëlqimit i mundëson subjektit të të dhënave kontroll nëse të dhënat personale të tij do të përpunohen apo jo.		
Sistemi CCTV është instaluar, sepse qëllimi për të cilin është instaluar ky sistem nuk mund të arrihet në një mënyrë tjetër.		
Sistemi CCTV nuk mbikëqyrin “imazhe”, “video” dhe “audio” në rrugë kalimi, trotuar, jashtë ambientit të zyrës dhe në dhoma që përdoren ekskluzivisht për qëllime private si tualete, dushe, zhveshje.		
Partia politike informon subjektet mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, nëpërmjet sistemit CCTV, nëpërmjet një njoftimi të vendosur në një vend të dukshëm, duke vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejimit të miratuar nga KDIMDP.		
Të dhënat e mbajtura me anë të sistemit të CCTV ruhen për një periudhë të caktuar, sa është e nevojshme por jo më shumë se dy muaj.		
Regjistrimet përdoren vetëm për hetimin e një ngjarje që ka sjellë dëmtimin e interesave të mbrojtura me ligj.		
Partia politike ka deleguar përpunimin e të dhënave nëpërmjet një subjekti të tretë dhe është lidhur kontrata e përpunimit (outsourcing)		
Partia politike angazhon 6 ose më shumë persona për përpunimin e të dhënave dhe ka miratuar Sistemin e Menaxhimit dhe Sigurisë së Informacionit.		
Partia politike angazhon më pak se 6 persona për përpunimin e të dhënave dhe ka miratuar rregulla për analizën e riskut, sigurinë fizike dhe të ambientit, sigurinë logjike të pajisjeve TIK të përpunimit të të dhënave personale dhe sigurinë e personelit.		
Partia politike i përpunon të dhënat personale për aq kohë sa është i nevojshëm qëllimi për të cilin janë grumbulluar dhe përpunuar.		

Metodat e mbledhjes së të dhënave:

- Mbledhja e informacionit dhe dokumentacionit nëpërmjet paraqitjes së kërkesave për informacion në bazë të ligjit për të drejtën e informimit pranë KDIMDP.
- Mbledhja e informacionit dhe dokumentacionit nëpërmjet administrimit të ankesave të qytetarëve.
- Paraqitjes së kërkesave për informacion pranë partive politike;
- Këqyrjes së faqeve zyrtare zyrtare në internet, aplikacioneve dhe rrjeteve sociale të partive politike.

12. Bibliografia

1. Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.
2. Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
3. Ligji nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar.
4. Vendim Nr.2, datë 10.3.2010 Për “Përcaktimin e Procedurave të Administrimit të Regjistrimit të të Dhënave, të Hedhjes së të Dhënave, të Përpunimit dhe Nxjerrjes së tyre”.
5. Udhëzim i KDIMDP nr. 35, datë 07.05.2013 “Për përpunimin e të dhënave personale për qëllime të fushatës zgjedhore”.
6. Udhëzim i KDIMDP Nr. 3 Datë 05.03.2010 Mbi “Përpunimin e të Dhënave Personale me Sistemin e Video Survejimit në Ndërtesa dhe Mjedisë të Tjera”.
7. Udhëzim i KDIMDP nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, i ndryshuar.
8. Udhëzim i KDIMDP nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”.
9. Udhëzim i KDIMDP Nr. 22, Datë 24.09.2012 Per "Përcaktimin e Rregullave për Ruajtjen e Sigurisë të të Dhënave Personale të Përpunuara nga Subjektet Përpunuese të Vogla”.
10. Udhëzues i KDIMDP për Përpunimin e të Dhënave Personale në Kontekstin e Fushatave Zgjedhore.
11. Vendim i KDIMDP Nr. 27, datë 13.6.2023 Për Kontrolluesin “Elton Zhuleku” Person Fizik.
12. Vendim i KDIMDP Nr. 03, datë 15.02.2023 Për Kontrolluesin “INSIG” SHA.
13. Vendim i KDIMDP Nr. 20 datë 18.05.2023 Për Kontrolluesin “Real Deal SH.P.K.”
14. Vendim i KDIMDP Nr. 08, datë 17.03.2023 Për Kontrolluesin “Canadian Kindergarten Tirana – KJL&CO SHPK”.
15. Vendim i KDIMDP Nr. 12 , Datë 26.07.2024 Për Kontrolluesin “Qendra e Zhvillimit të Fëmijëve me Aftësi Ndryshe”, Bashkia Lushnjë.
16. Vendim Nr. 01, datë 17.01.2023 Për Kontrolluesin “Toronto Group” SHPK.
17. Rekomandim i KDIMDP nr. 12 datë 27.02.2014.
18. Rekomandim i KDIMDP nr. 13 datë 27.02.2014.
19. Rekomandim i KDIMDP nr. 44 datë 19.08.2024.
20. Raporti Vjetor 2021 i KDIMDP.
21. Raporti Përfundimtar i Misionit të Kufizuar të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare, 25 prill 2021.
22. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr. 00 - 2023 - 5377 i Vendimit (786) datë 27.12.2023.
23. Vendim i GJEDNJ Catt kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2019.

24. Vendim i GJEDNJ Segerstedt-Wiberg dhe të tjerët kundër Suedisë, 2006
25. Këqyrje faqe interneti <https://rm.coe.int/report-privacy-voter-surveillance-and-democratic-engagement-2774-4663-/1680a10852> , aksesuar më datë 09.09.2024.
26. Këqyrje faqe interneti <https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2018/12/contents> aksesuar më datë 11.09.2024.
27. Këqyrje faqe interneti https://icosearch.ico.org.uk/s/search.html?query=political+campaign&collection=ico-meta&profile=_default , aksesuar më datë 09.09.2024.
28. Këqyrje faqe interneti <https://ico.org.uk/media/action-ëeve-taken/2259369/democracy-disrupted-110718.pdf> , aksesuar më datë 09.09.2024.
29. Këqyrje faqe interneti , <https://aip.rks-gov.net/download/komunikimi-me-qytetare-gjate-fushates-zgjedhore/?wpdmdl=6677&refresh=66f3d441f36a8172725561> , aksesuar më datë 19.09.2024.
30. Këqyrje faqe interneti <https://aip.rks-gov.net/download/komunikimi-me-qytetare-gjate-fushates-zgjedhore/?wpdmdl=6677&refresh=66f3d441f36a8172725561> , aksesuar më datë 22.09.2024.
31. Këqyrje faqe interneti <https://azop.hr/preporuke-za-obradu-osobnih-podataka-uoci-lokalnih-izbora-2021/> aksesuar më datë 23.09.2024.
32. Këqyrje faqe interneti <https://www.electoralcommission.org.uk/running-electoral-registration-wales/your-role-and-responsibilities-electoral-registration-officer> , aksesuar më datë 19.09.2024.
33. Këqyrje faqe interneti <https://www.electoralcommission.org.uk/voting-and-elections/how-elections-work/electoral-register> , aksesuar më datë 20.09.2024.
34. Këqyrje faqe interneti <https://www.izbori.hr/site/UserDocs/Images/Zakoni%20-%20engl/Zakon o registru biraca NN 144-12 EN.pdf> , aksesuar më datë 20.09.2024.
35. Këqyrje faqe interneti <https://kqz-ks.org/sherbimet-per-votuesit/lista-votuese/> aksesuar më datë 20.09.2024.

Aneks 1: Matrica Krahasuese

INDIKATORË	PARTIA SOCIALISTE			PARTIA DEMOKRATIKE			PARTIA E LIRISË		
MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE	PIKA TË FORTA	DOBËSITË	REKOMANDIME	PIKA TË FORTA	DOBËSITË	REKOMANDIME	PIKA TË FORTA	DOBËSITË	REKOMANDIME
Partia politike përpunon të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare zyrtare në internet dhe ka publikuar “Politikat e Privatësisë”.	-	Nuk janë publikuar Politika të Privatësisë.	Politikat e privatësisë duhet të publikohen në gjuhën shqipe dhe të informojnë për llojin e të dhënave personale që përpunohen, qëllimin, mënyrën dhe kohëzgjatjen e përpunimit, mënyrën dhe kohën si mund të tërhiqet dhënia e pëlqimit, të drejtat e subjektit të dhënave për akses, të drejtën për fshirje dhe/ose korrigjim të të dhënave, emërtimin dhe kontaktin e kontrolluesit dhe të çdo pale të tretë që mund të përpunojë të dhëna personale për llogari të tij, dhe masat organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale.	Subjektet e të dhënave informohen për:- Të drejtën për akses, të drejtën për të kërkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen, të drejtën për të revokuar pëlqimin e dhënë për të përpunuar të dhëna personale, të drejtën për të transferuar të dhënat, të drejtën për të kundërshtuar.- Emërtimin e kontrolluesit dhe të dhënat e tij të kontaktit.	Politikat e privatësisë nuk janë publikuar në gjuhën shqipe dhe nuk informojnë për llojin e të dhënave personale që përpunohen, qëllimin, mënyrën dhe kohëzgjatjen e përpunimit, nëse dhënat personale përpunohen në bazë të pëlqimit apo detyrimi ligjor, masat organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale.	Politikat e privatësisë duhet të publikohen në gjuhën shqipe dhe të informojnë për llojin e të dhënave personale që përpunohen, qëllimin, mënyrën dhe kohëzgjatjen e përpunimit, nëse dhënat personale përpunohen në bazë të pëlqimit apo detyrimi ligjor, masat organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale.	-	Nuk janë publikuar Politika të Privatësisë.	Politika të Privatësisë duhet të publikohen në gjuhën shqipe, të informojnë për llojin e të dhënave personale që përpunohen, qëllimin, mënyrën dhe kohëzgjatjen e përpunimit, mënyrën dhe kohën si mund të tërhiqet dhënia e pëlqimit, të drejtat e subjektit të dhënave për akses, të drejtën për fshirje dhe/ose korrigjim të të dhënave, emërtimin dhe kontaktin e kontrolluesit dhe të çdo pale të tretë që mund të përpunojë të dhëna personale për llogari të tij, dhe masat organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale.
Partia politike ka marr pëlqimin e subjektit të të	Parashikohet mundësia e dhënies së pëlqimit për	Subjekti i të dhënave nuk njihet me qëllimin	Subjekti i të dhënave duhet të njihet me qëllimin dhe mënyrën e	-	Nuk parashikohet mundësia e subjektit të të	Duhet të garantohet dhënia e pëlqimit nga subjekti i të	Parashikohet mundësia e dhënies së pëlqimit për	Subjekti i të dhënave nuk njihet me qëllimin	Subjekti i të dhënave duhet të njihet me qëllimin dhe mënyrën e

<p>dhënave për përpunimin e të dhënave.</p>	<p>përpunimin e të dhënave personale.</p>	<p>dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje,etj.).</p>	<p>përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje,etj.).</p>	<p>dhënave për dhënien e pëlqimit për përpunimin e të dhënave personale. Subjekti i të dhënave nuk njihet me qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje,etj.).</p>	<p>dhënave në formë shkresore, shprehimisht dhe me vullnet të plotë e të lirë. Subjekti i të dhënave duhet të njihet me qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje,etj.).</p>	<p>përpunimin e të dhënave personale.</p>	<p>dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje,etj.).</p>	<p>përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje,etj.).</p>
--	---	---	---	--	---	---	---	---

Aneks 2 – Analizë e plotë e legjislacionit vendas lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga partitë politike

i. Detyrimi i regjistrimit të anëtarëve

Partitë politike janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit⁷⁸. Partitë politike e fitojnë personalitetin juridik nëpërmjet vendimit të gjykatës nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë. Partia politike për t'u regjistruar në gjykatë dhe fituar personalitet juridik, duhet të depozitohet në sekretarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë kërkesë të nënshkruar nga jo më pak se 3 000 anëtarë themelues.

Kërkesa e mësipërme për regjistrimin e një partie politike duhet të përmbajë për çdo anëtar themelues:

- a) emrin dhe mbiemrin;
- b) numrin personal;
- c) vendbanimin⁷⁹.

Informacioni i mësipërm, i cili përpunohet nga partia politike për anëtarët e saj themelues përbën të dhënë personale⁸⁰ dhe gëzon mbrojtje nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Gjithashtu, informacioni për mendimet politike të një individi përbën të dhënë sensitive⁸¹ dhe në këtë mënyrë rezulton që partitë politike përpunojnë edhe të dhëna sensitive për anëtarët e tyre.

Si rregull, përpunimi i të dhënave personale sensitive është i ndaluar, ndërkohë që ligji ka parashikuar edhe disa raste përjashtimore kur mund të përpunohen këto të dhëna. Të dhënat sensitive mund të përpunohen nga partitë politike, për qëllime të veprimtarisë të tyre të ligjshme, vetëm për anëtarët, sponsorizuesit ose personat e tjerë, që kanë lidhje me veprimtarinë e tyre. Këto të dhëna nuk u bëhen të njohura palëve të treta, pa pëlqimin e subjektit të të dhënave, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj⁸².

Mbas regjistrimit të themelimit të partisë politike, pranimi i anëtarëve të rinj mund të realizohet duke përpunuar të njëjtat të dhëna si për anëtarët themelues (emrin dhe mbiemrin, numrin personal dhe vendbanimin). Në nenin 14 të ligjit nr. 8580/2000 "Për partitë politike", të ndryshuar, ligjvënësi ka përcaktuar në mënyrë të qartë se, të njëjtat rregulla ligjore të cilat përcaktohen për regjistrimin për së pari të një partie politike, ndiqen dhe janë

⁷⁸ Neni 1 i ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar.

⁷⁹ Nenet 9 dhe 10 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar.

⁸⁰ Neni 3 pika 1 i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar parashikon që: "Të dhëna personale" është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

⁸¹ Neni 3 pika 4 i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar parashikon që: "Të dhëna sensitive" është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.

⁸² Neni 7 pika 2.e i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

njëlloj të vlefshme për ndryshimet dhe fshirjet në regjistrimet e mëparshme, në rastin kur organet apo forumet e partisë politike bëjnë ndryshime statutores, ndryshojnë, shfuqizojnë apo krijojnë rregulla të reja organizimi apo funksionimi, ndryshojnë emërtimet apo organet drejtuese të tyre⁸³.

Pranimi i anëtarëve themelues dhe pranimi i anëtarëve të rinj duhet të realizohet duke shprehur subjekti i të dhënave pëlqimin e tij të qartë, të kuptueshëm dhe në formë të shkruar për përpunimin e të dhënave të tij sensitive, pasi të jetë informuar në mënyrë të plotë dhe të kuptueshme për qëllimin e përpunimit të këtyre të dhënave⁸⁴. Partitë politike duhet të mbajnë informacione të sakta, të plota dhe të përditësuara lidhur me të gjitha të dhënat personale të regjistruara për anëtarët sipas përcaktimeve në nenin 10 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” dhe ky informacion duhet të mbahet në mënyrë të kujdesshme, duke u zbatuar të gjitha masat teknike dhe organizative për përpunimin e tij në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale⁸⁵.

ii. Përpunimi i të dhënave personale për qëllime të fushatës zgjedhore

Ndarja ose kombinimi i paautorizuar i të dhënave personale të votuesve për qëllimet e supozuara të angazhimit demokratik mund të konsiderohet shkelje e angazhimit për mbrojtjen e të drejtës për jetën private dhe familjare⁸⁶.

Gjatë fushatës zgjedhore çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të bëjë propaganda zgjedhore në çdo mënyrë të ligjshme⁸⁷.

Përpunimi i të dhënave personale të zgjedhësve, legjitimohet, kur kjo kryhet në dy mënyra:

- 1.** *nëse zgjedhësi ka dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave, ose*
- 2.** *në rastin e parashikuar nga Kodi Zgjedhor.*

Kur baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale është pëlqimi, ai duhet të jetë i dhënë lirisht, për një qëllim specifik, i informuar dhe i qartë, duke pasur gjithashtu mundësinë e revokimit të tij në çdo moment.

Kur subjektet zgjedhore mbështeten te “*parashikimi ligjor*” në nenin 60 pika 1 i ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” për përpunimin e të dhënave personale të mbledhura nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe/ose Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në çdo rast kjo arsye legjitime duhet t’u bëhet e njohur zgjedhësve⁸⁸.

Çdo kandidat i regjistruar pranë KQZ i cili do të përpunojë të dhëna personale të zgjedhësve për qëllime të fushatës zgjedhore, detyrohet:

- t’i mbledhë të dhënat personale drejtpërdrejtë nga zgjedhësit,
- duke siguruar që këta të fundit janë informuar për:
 - a. qëllimin e mbledhjes së të dhënave dhe

⁸³ Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr. 00 - 2023 - 5377 i Vendimit (786) datë 27.12.2023, pika 31.

⁸⁴ Pika III.3, Vendim Nr.2, datë 10.3.2010 Për “Përcaktimin e Procedurave të Administrimit të Regjistrimit të të Dhënave, të Hedhjes së të Dhënave, të Përpunimit dhe Nxjerrjes së tyre”.

⁸⁵ Pika I.2, Vendim Nr.2, datë 10.3.2010 Për “Përcaktimin e Procedurave të Administrimit të Regjistrimit të të Dhënave, të Hedhjes së të Dhënave, të Përpunimit dhe Nxjerrjes së tyre”.

⁸⁶ Paragrafi 24 i Dokumentit të OSBE-së të Moskës të vitit 1991; Faqe 19, Raporti Përfundimtar i Misionit të Kufizuar të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare, 25 prill 2021.

⁸⁷ Neni 78 pika 1 i ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

⁸⁸ Faqe 10, Udhëzues për Përpunimin e të Dhënave Personale në Kontekstin e Fushatave Zgjedhore.

b. për mënyrën e përdorimit të tyre⁸⁹.

iii. Përpunimi i të dhënave personale nëpërmjet pëlqimit të zgjedhësit.

Nëse kandidati përpunon të dhëna personale si: detajet e pikëpamjeve politike, mendimeve, apo ndonjë tregues të synimeve të votimit si dhe në rast se i përdor të dhënat personale të mbledhura drejtpërdrejt nga zgjedhësit për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë⁹⁰, atëherë duhet të:

i. merret paraprakisht pëlqimi nga zgjedhësi. Pëlqimi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) është dhënë me shkrim;

b) mban datën dhe nënshkrimin;

c) është dhënë lirisht pas marrjes së informacionit të detajuar në lidhje me natyrën, rëndësinë, efektet, etj;

ç) është i dokumentuar⁹¹

ii. merren masa mbrojtëse shtesë për të mbrojtur këtë informacion dhe të dhënat personale sensitive shkatërrohen në mënyrë të sigurt.

iii. të vendoset në dispozicion komunikim një numër telefoni pa pagesë, në të cilin zgjedhësit mund të kërkojnë në mënyrë të thjeshtë ndalimin e tregtimit të drejtpërdrejtë.

Në rast se kandidati përpunon të dhënat personale të mbledhura drejtpërdrejtë nga zgjedhësit për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë nëpërmjet subjekteve të treta, duhet të lidhet kontrata e përpunimit (outsourcing) bazuar në Udhëzimin Nr. 19, datë 03.08.2012 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes Kontrolluesit dhe Përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”.

Zgjedhësit kanë të drejtë në çdo kohë të kërkojnë nga kandidati ndalimin e përpunimit të të dhënave sensitive dhe tregtimit të drejtpërdrejtë⁹².

iv. Përpunimi i të dhënave personale në rastin e parashikuar nga Kodi Zgjedhor.

Listat e zgjedhësve dhe ekstraktet e përbërësve zgjedhorë vihen në dispozicion të subjekteve zgjedhore ose, sipas rastit, partive politike, me kërkesën e tyre dhe pa pagesë, nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe/ose Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Subjektet zgjedhore të regjistruara në KQZ ose partitë politike, me kërkesën e tyre dhe pa pagesë, mund të marrin nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile një

⁸⁹ Neni 3.1, udhëzim Nr. 35, datë 07 .05. 2013 Per “Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime të Fushatës Zgjedhore”.

⁹⁰Faqja 1, shembull që thjeshton zbatimin e udhëzimit Nr. 35, datë 07 .05. 2013 Për “Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime të Fushatës Zgjedhore” (...) tregtimi i drejtpërdrejtë nuk është vetëm shitja e mallrave dhe shërbimeve, por përfshin githashtu promovimin e qëllimeve dhe idealeve të cdo organizate duke përfshirë edhe partitë politike (nëpërmjet dërgimit të mesazheve me faks, sms, email). I tillë është inkurajimi i individëve që të votojnë për një parti apo kandidat të veçantë. Tregtimi përfshin komunikimin “drejtuar një individ të veçantë” (...).

⁹¹ Neni 2.5 dhe 6.1, udhëzim Nr. 35 , datë 07 .05. 2013 Per “Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime Të Fushatës Zgjedhore.

⁹² Neni 6, udhëzim Nr. 35 , datë 07 .05. 2013 Per “Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime Të Fushatës Zgjedhore”

kopje elektronike të listave të zgjedhësve ose ekstraktit të përbërësve zgjedhorë në shkallë vendi, si dhe sa herë që ato përditësohen dhe publikohen. Kopja elektronike hartohet në mënyrë të tillë që të lejojë kërkime dhe krahasime të kryqëzuara të të dhënave⁹³. Kandidati mund të përdorë të dhënat personale të mbledhura nga lista e zgjedhësve në Regjistrin Kombëtar Elektronik të Gjendjes Civile, vetëm për qëllime që lidhen me zgjedhjet⁹⁴.

Të dhënat e marra nga këto lista zyrtare të zgjedhësve nuk duhen kombinuar me burime të tjera të dhënash personale, me qëllim krijimin e profileve të zgjedhësve nëpërmjet shënjestrimit.⁹⁵ Sa më sipër, mundëson që subjektet zgjedhore të “profilizojnë” zgjedhësit me saktësi gjithnjë e më të lartë e të dërgojnë mesazhe të “shënjestruara” nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit duke ndikuar në bindjet e tyre politike⁹⁶.

Në rast se kandidati delegon përpunimin e listës zgjedhore të subjekte, të treta në këtë rast duhet të lidhet kontrata e përpunimit (outsourcing) dhe Udhëzimi i KDIMDP Nr. 19, datë 03.08.2012 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes Kontrolluesit dhe Përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”.

Pavarësisht se KDIMDP ka miratuar vendimin Nr. 4, datë 27.12.2012 “Për përcaktimin e rasteve për përjashtimet nga detyrimi për njoftimin e të dhënave personale që përpunohen”, nëpërmjet të cilit parashikon që kontrolluesi nuk është i detyruar të njoftojë KDIMDP kur përpunimi i të dhënave personale kryhet nga partitë politike, për qëllime të veprimtarisë së tyre të ligjshme, për anëtarët, sponsorizuesit ose personat e tjerë, që kanë lidhje të vazhdueshme me veprimtarinë e këtyre organizatave, në rastet kur kandidati përpunon të dhëna personale për qëllime të fushatës zgjedhore në mënyrë manuale si dhe duke përdorur pajisje elektronike, të tilla si kompjuter, email, faks, sms, ai është i detyruar të njoftojë paraprakisht KDIMDP⁹⁷.

Në rast se kandidati rezulton fitues në zgjedhje, ai do të vijojë të jetë i regjistruar në regjistrin e KDIMDP për aq kohë sa ai qëndron në detyrë, ndërkohë që KQZ detyrohet të paraqesë pranë KDIMDP listën e kandidatëve fitues dhe humbës të zgjedhjeve elektorale, në mënyrë që ky i fundit të kryejë fshirjen e regjistrimit nga regjistri të kandidatëve jo fitues në zgjedhjet elektorale⁹⁸.

v. Informimi i subjektit të të dhënave (Të dhënat që përpunohen, vullnetare apo detyrim ligjor, të drejtat, etj.).

Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij.

⁹³ Neni 60 pika 1 i ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

⁹⁴ Neni 3, udhëzim Nr. 35 , datë 07 .05. 2013 Per “Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime Të Fushatës Zgjedhore”

⁹⁵ Faqe 11, Udhëzues Për Përpunimin e të Dhënave Personale në Kontekstin e Fushatave Zgjedhore.

⁹⁶ Faqe 5, Udhëzues Për Përpunimin e të Dhënave Personale në Kontekstin e Fushatave Zgjedhore.

⁹⁷ Neni 5.1, udhëzim Nr. 35 , datë 07 .05. 2013 Për “Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime të Fushatës Zgjedhore”

⁹⁸ Neni 5.1 dhe 5.2, udhëzim Nr. 35 , datë 07 .05. 2013 Për “Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllime të Fushatës Zgjedhore”

Në rast se kontrolluesi përpunon të dhëna personale, të marra nga subjekti i të dhënave, ai është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare. Nëse subjekti i të dhënave, në bazë të një akti ligjor ose nënligjor, është i detyruar të japë të dhëna personale për përpunim, kontrolluesi e informon edhe rreth këtij fakti, si dhe rreth pasojave të refuzimit të dhënies së të dhënave personale⁹⁹.

Kontrolluesi nuk është i detyruar të japë informacion dhe të informojë për rastet kur të dhënat personale nuk janë marrë nga subjekti i të dhënave, nëse detyrohet të kryejë përpunimin e të dhënave personale në bazë të një parashikimi ligjor, përpunon të dhëna të bëra publike ose përpunon të dhëna personale, të marra me pëlqimin e subjektit të të dhënave¹⁰⁰.

Në rast se një individ paraqet kërkesë për informacion pranë kontrolluesit nëse të dhënat personale po i përpunohen ose jo, për qëllimin e përpunimit, për kategoritë e të dhënave të përpunuara dhe për subjektet të cilëve u përhapen të dhënat personale dhe për burimin të dhënave personale, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, informon subjektin e të dhënave ose i shpjegon atij arsyet e mosdhënies së informacionit¹⁰¹.

vi. Bllokimi, korrigjimi ose fshirja e të dhënave

Kontrolluesi duhet të kryejë edhe kryesisht bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, kur vëren se janë të parregullta, të pavërteta, të paplota ose janë përpunuar në kundërshtim me ligjin¹⁰².

Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, pa pagesë, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me ligjin dhe kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e bllokimit, korrigjimit apo të fshirjes¹⁰³.

vii. Hartimi i rregullores për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale

Partitë politike duhet të miratojnë *“Rregullore për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori të dhënash), sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, nivelet e aksesit etj., sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe Vendimin nr. 6, datë 05.08.2013 të Komisionerit *“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”*, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset

⁹⁹ Neni 18 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

¹⁰⁰ Neni 18 pika 3 e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

¹⁰¹ Neni 12 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

¹⁰² Neni 19 pika 1 i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

¹⁰³ Neni 13 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

përpunuese të Kontrolluesit dhe shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave¹⁰⁴.

Partitë politike duhet të hartojnë dhe miratojnë rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, mbështetur në projekt/rregulloren *tip* të hartuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale¹⁰⁵.

Si rregull, çdo kontrollues duhet të njoftojë KDIMDP për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës, para se të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, të njoftuar më parë. Pavarësisht këtij parashikimi të përgjithshëm ligjor, KDIMDP ka miratuar një vendim¹⁰⁶ nëpërmjet të cilit janë parashikuar disa raste për të cilat njoftimi i KDIMDP për përpunimin e të dhënave personale nuk është i nevojshëm. Sipas kësaj dispozite kontrolluesi nuk është i detyruar të njoftojë KDIMDP kur përpunimi i të dhënave personale kryhet nga partitë politike, për qëllime të veprimtarisë së tyre të ligjshme, për anëtarët, sponsorizuesit ose personat e tjerë, që kanë lidhje të vazhdueshme me veprimtarinë e këtyre organizatave.

viii. Përpunimi i të dhënave nëpërmjet faqes zyrtare në internet

Çdo parti politike që përpunon të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare të tij, ka detyrimin që të publikojë “*Politikat e Privatësisë*”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me kontrolluesin realizohet përmes faqes online të internetit. Në këtë kuadër, publikimi i rubrikës “*Politikat e Privatësisë*” në faqen zyrtare të kontrolluesit, duhet të përmbushë qëllimin e informimit përkundrejt subjekteve të të dhënave, të cilët aksesojnë dhe ngarkojnë të dhëna personale në faqe. Njëkohësisht, informimi sipas përcaktimeve të nenit 18 të ligjit duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale, në rast se kontrolluesi përpunon të dhëna personale, të marra drejtpërdrejtë nga subjekti i të dhënave¹⁰⁷.

Politikat e privatësisë në faqen zyrtare në internet të kontrolluesit duhet të pasqyrohen në gjuhën shqipe dhe kontrolluesi duhet të informojë subjektet e të dhënave (individë që aksesojnë faqen zyrtare në internet, punëmarrësetj.), në përputhje me parashikimet e nenit 18 të ligjit për:

- Llojin e të dhënave personale që përpunohen;
- Qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale;
- Personin që do t'i përpunojë të dhënat, kontaktin e tij dhe të çdo pale të tretë që mund të përpunojë të dhëna personale për llogari të tij;
- Mënyrën e përpunimit;
- Nëse dhënat personale përpunohen në bazë të pëlqimit apo detyrimi ligjor;
- Mos përdorimin e të dhënave për qëllime të tjera;
- Përcaktimin e periudhës kohore të ruajtjes së të dhënave personale;

¹⁰⁴ Vendim Nr. 27, datë 13.6.2023 PËR KONTROLLUESIN “ELTON ZHULEKU” Person Fizik. Vendim Nr. 03, datë 15.02.2023 PËR KONTROLLUESIN “INSIG” SHA, pika 7.

¹⁰⁵ Pika 3, Vendim Nr. 6, datë 05.08.2013 Për Përcaktimin e Rregullave të Hollësishme për Sigurimin e të Dhënave Personale.

¹⁰⁶ Pika 1.a e vendimit të KDIMDP Nr. 4, datë 27.12.2012 “Për përcaktimin e rasteve për përjashtimet nga detyrimi për njoftimin e të dhënave personale që përpunohen”.

¹⁰⁷ Vendim Nr. 20 datë 18.05.2023 Për Kontrolluesin “Real Deal SH.P.K.” pika 2.

- Masat organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale;
- Të drejtën për akses, të drejtën për fshirje dhe/ose korrigjim të të dhënave, të drejtën për t'u ankuar dhe për kompensimin e dëmit.

Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mos përmbushja e këtij detyrimi nga ana e kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave¹⁰⁸.

ix. Publikimi i fotove nga aktivitetet në rrjetet sociale

Në rastet kur kontrolluesi pasqyron në llogaritë e biznesit të krijuara prej tij në rrjetet sociale (Facebook, Instagram, Twitter, etj.) aktivitete nëpërmjet publikimit të fotografive dhe videove të individëve, kontrolluesi duhet të kryejë marrjen e pëlqimit paraprak ndaj subjektit të të dhënave për publikimin e fotografive/videove në rrjetet sociale që administron, në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të ligjit. Përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, përmes publikimit të fotografive/videove të subjekteve të të dhënave në rrjetet sociale, pa marrë paraprakisht "*Pëlqimin*" me shkrim bie në kundërshtim me nenet 5 dhe 6 të Ligjit¹⁰⁹.

Dhënia e këtij "*Pëlqimi*" duhet të plotësojë kërkesat e ligjit, konkretisht duhet garantuar në formë shkresore, i dhënë shprehimisht, me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen përse të dhënat do të përpunohen. Kur kërkon "*pëlqimin*", kontrolluesi duhet të vlerësojë nëse ai i plotëson të gjithë kriteret për të garantuar një "*pëlqim*" të vlefshëm. Nëse është marrë në përputhje me ligjin, "*pëlqimi*" është një mjet që i mundëson subjektit të të dhënave kontroll nëse të dhënat personale të tij do të përpunohen apo jo¹¹⁰. Pëlqimi quhet i vlefshëm kur subjekti i të dhënave njihet me qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje) etj., në përputhje me parashikimet e nenit 18 të ligjit¹¹¹.

x. Përpunimi i të dhënave nëpërmjet mbikëqyrjes me "imazhe", "video" dhe "audio"

Një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video/audio-survejmimit (CCTV). Të dhënat e ruajtura në këto sisteme, si: "*imazhe*", "*video*" dhe "*audio*", janë të dhëna personale dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e ligjit.

Përpunimi i të dhënave me anë të një sistemi video survejimi mund të lejohet vetëm nëse qëllimi për të cilin është instaluar ky sistem nuk mund të arrihet në një mënyrë tjetër. Instalimi i një sistemi video survejimi është i ndaluar në rrugë kalimi, trotuar, jashtë ambientit

¹⁰⁸ Vendim Nr. 03, datë 15.02.2023 Per Kontrolluesin "INSIG" SHA, pika 3. Vendim Nr. 20 datë 18.05.2023 Për Kontrolluesin "Real Deal SH.P.K." pika 2.

¹⁰⁹ Vendim Nr. 08, datë 17.03.2023 Për Kontrolluesin "Canadian Kindergarten Tirana – KJL&CO SHPK", pika 2

¹¹⁰ Vendim Nr. 08, Datë 17.03.2023 Për Kontrolluesin "Canadian Kindergarten Tirana – KJL&CO SHPK", pika 4.

¹¹¹ Vendim Nr. 73, datë 27.12.2023 Për Kontrolluesin "Montessori Tirana" shpk, pika 3.

të zyrës dhe në dhoma që përdoren ekskluzivisht për qëllime private si tualete, dushe, zhveshje¹¹².

Kontrolluesi duhet të parashikojë rregulla/politika lidhur me mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit CCTV dhe të marrë masa teknike-organizative, në mënyrë që të mbrohen sistemet e regjistrimit, mënyrat e transferimit dhe mjetet transmetuese në të cilin gjenden regjistrimet duke i mbrojtur nga akseset e paautorizuara apo aksidentale, ndryshimi, shkatërrimi, humbja ose përpunimi i paautorizuar, si dhe të sigurojë ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave¹¹³.

Kontrolluesi duhet të informojë subjektet mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, nëpërmjet sistemit CCTV, në përputhje me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar. Subjektet e të dhënave duhet të informohen në mënyrë të qartë dhe nëpërmjet një njoftimi të vendosur në një vend të dukshëm që një sistem video-survejmimi është në veprim, duke vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejimit të miratuar nga KDIMDP¹¹⁴.

Të dhënat e mbajtura me anë të sistemit të video survejimit mund ruhen për një periudhë të caktuar, sa është e nevojshme për përmbushjen e qëllimit të video survejimit. Në çdo rast, të dhënat e mbajtura me anë të sistemit CCTV do ruhen për një periudhë deri në dy muaj dhe pas kalimit të kësaj periudhe të dhënat duhet të fshihen. Regjistrimet mund të përdoren vetëm për hetimin e një ngjarje që ka sjellë dëmtimin e interesave të mbrojtura me ligj¹¹⁵. Kontrolluesi duhet të mbajë një regjistër për shënimin e rasteve kur imazhet video janë aksesuar apo transferuar te të tretë (p.sh. policisë, prokurorisë, gjykatës).

xi. Delegimi i përpunimit të dhënave te të tretët

Delegimi i përpunimit të dhënave personale nëpërmjet një subjekti të tretë do të thotë kur kontrolluesit hyjnë në marrëdhënie me subjekte të treta dhe bien dakord që këto kompani të kryejnë përpunimin e të dhënave personale për llogari të tyre¹¹⁶.

Në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave nëpërmjet një subjekti të tretë kontrolluesi duhet të miratojë një kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të përpunuesit të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose shërbimit, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt

¹¹² Pika 4.a Udhëzim Nr. 3 Datë 05/03/2010 Mbi “Përpunimin e të Dhënave Personale me Sistemin e Video Survejimit në Ndërtesa dhe Mjedise të Tjera”.

¹¹³ Pika 4. ç Udhëzim Nr. 3 Datë 05/03/2010 Mbi “Përpunimin e të Dhënave Personale me Sistemin e Video Survejimit në Ndërtesa dhe Mjedise të Tjera”. Vendim Nr. 12 , Datë 26 . 07 .2024 Për Kontrolluesin “Qendra e Zhvillimit të Fëmijëve me Aftësi Ndryshe”, Bashkia Lushnjë, Pika 4.

¹¹⁴ Pika 4.dh Udhëzim Nr. 3 Datë 05/03/2010 Mbi “Përpunimin e të Dhënave Personale me Sistemin e Video Survejimit në Ndërtesa dhe Mjedise të Tjera”. VendimNr. 23, datë 01.6.2023 PËr Kontrolluesin “Posta Shqiptare Sh.A si dhe Struktura në Varësi të Saj (Zyra Postare Tirana 5, Zyra Postare Tirana 2, Zyra Postare Tirana 8)”

¹¹⁵ Pika 4.b Udhëzim Nr. 3 Datë 05/03/2010 Mbi “Përpunimin e të Dhënave Personale me Sistemin e Video Survejimit në Ndërtesa dhe Mjedise të Tjera”.

¹¹⁶ Pika 2, udhëzim nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, i ndryshuar.

të të dhënave¹¹⁷. Kontrata e përpunimit (outsourcing) është akti në bazë të të cilit kontrolluesi i kërkon përpunuesit të kryejë për llogari të tij një pjesë të përpunimit të të dhënave personale. Në zbatim të këtij detyrimi, KDIMDP ka miratuar Aneksin I Kontratë-tip për Përpunimin e të Dhënave Personale nga një Kompani e Tretë, e cila i bashkëlidhet Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, i ndryshuar.

Çdo kontratë e tillë parashikon çdo masë që merr përpunuesi për të siguruar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cënimi të të dhënave.

Kontrata e përpunimit siguron që:

- a) përpunuesi përdor dhe përhap të dhënat personale vetëm sipas udhëzimeve të kontrolluesit;
- b) përpunuesi merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave¹¹⁸.

xii. Detyrimet për subjektet përpunues të mëdhenj

Legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale ka parashikuar detyrime të posaçme për subjektet të cilët angazhojnë 6 ose më shumë persona për përpunimin e të dhënave. Këta të fundit quhen subjekt përpunues i madh. Për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale¹¹⁹, kontrolluesit, duhet të përmbushin detyrimet e mëposhtme:

- *Krijimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Sigurisë së Informacionit për Mbrojtjen e të dhënave (SMSI)* Ky sistem bazohet në identifikimin, analizimin dhe në zbutjen e rreziqeve ndaj sigurisë së të dhënave personale¹²⁰.
- *Analiza e Ndikimit të të Dhënave Personale*. Përpara përpunimit të të dhënave personale, kontrolluesi duhet të kryejë një vlerësim të ndikimit të operacioneve të përpunimit që janë parashikuar për mbrojtjen e të dhënave personale, duke evidentuar se ku këto operacione përpunimi mund të paraqesin rreziqe të vecanta ndaj të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave. Ky dokument përfshihet në SMSI¹²¹.
- *Politika e Sigurisë dhe Informacionit*. Ky dokument duhet të specifikojë qartë objektivat e sigurisë dhe masat teknike, organizative edhe në lidhje me personelin, për zbutjen kërcënimeve dhe rreziqeve që prekin sistemet e arkivimit.
- *Kontrolli i Sigurisë së Informacionit*. Kontrolli i sigurisë së të dhënave personale nga subjektet përpunuese kryhet jo më pak se një herë në vit.

¹¹⁷ Vendim Nr. 01, datë 17.01.2023 Për Kontrolluesin “Toronto Group” SHPK, pika 2.

¹¹⁸ Pika 10, udhëzimi nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, i ndryshuar.

¹¹⁹ Vendim Nr. 23, datë 01.6.2023 PËR Kontrolluesin “Posta Shqiptare Sh.A si dhe Struktura në Varësi të Saj (Zyra Postare Tirana 5, Zyra Postare Tirana 2, Zyra Postare Tirana 8)”

¹²⁰ Pika nr.8, udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”

¹²¹ Pika nr.11.a, udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”

- *Trajnimi i personelit.* Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve, që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale. Ky është një detyrim i vazhdueshëm i kontrolluesit që personeli i subjektit përpunues të të dhënave personale të trajnohet rregullisht për mbrojtjen e të dhënave personale¹²². Personeli duhet të trajnohet të paktën një herë në vit dhe pas çdo ndryshimi thelbësor të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, Politikave të Sigurisë dhe Informacionit, Sistemit të Menaxhimit dhe Sigurisë së Informacionit, etj¹²³.
- *Caktimi i personit të kontaktit.* Subjektet përpunuese të mëdha kanë detyrimin që të caktojnë me shkrim të paktën një person kontakti, të ngarkuar me mbikëqyrjen e brendshme të mbrojtjes së të dhënave personale. Kontrolluesi duhet të njoftojë KDIMDP për caktimin e personit të kontaktit¹²⁴.

xiii. Detyrimet për subjektet përpunuese të vogla

Subjekte përpunuese të vogla janë kontrolluesit ose përpunuesit të cilët përpunojnë të dhëna personale në mënyrë elektronike ose manuale, duke shfrytëzuar më pak se 6 persona¹²⁵. Këto subjekte duhet të plotësojnë standardet minimale për sigurinë e të dhënave personale si më poshtë:

- *Analizën e riskut.* Analiza e riskut identifikon kërcënimet që prekin pjesë individuale të sistemit të arkivimit, të afta të shkelin sigurinë apo funksionimin e tij. Analiza e riskut kryhet në mënyrë periodike dhe dokumentohet në mënyrë të kuptueshme për praktikën e veprimtarisë së subjekteve përpunuese¹²⁶.
- *Sigurinë fizike dhe të ambientit.* Sistemet e përpunimit të informacionit, programe ose pajisje të Teknologjisë Informacionit dhe Komunikimit (TIK) ku mbahet një databazë duhet të aksesohen me fjalëkalim. Gjithmonë të bëhet backup-i (një kopje sigurie) i të dhënave në një ambient tjetër të sigurtë. Në pajisjet TIK duhet të lejohet aksesu fizik për përpunimin e të dhënave personale, vetëm për personat e autorizuar dhe të mbahen regjistrime të identitetit të tyre. Të gjitha pajisjet fizike që mbajnë të dhëna personale, kur ato e kanë përmbushur qëllimin për të cilin ishin grumbulluar ose përpunuar, duhet të shkatërrohen përfundimisht¹²⁷.
- *Sigurinë logjike të pajisjeve TIK të përpunimit të të dhënave personale.* Në rast se përdoren pajisje TIK për përpunimin e të dhënave personale duhet të të disponohen programe (software) të ligjshëm për përpunimin e të dhënave personale që mundësojnë përditësimet e sigurisë për përdoruesit e ligjshëm, të instalohen masa sigurie duke përdorur mjete identifikimi si “emër përdoruesi” dhe “fjalëkalim”, etj¹²⁸.
- *Sigurinë e personelit.* Punëmarrësit duhet të informohen mbi rreziqet kryesore ndaj të cilave janë të ekspozuar, duhet të zhvillohen trajnime në varësi të rrezikut të

¹²³ Pika nr.24, Udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”

¹²⁴ Pika nr.27, Udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”

¹²⁵ Pika 2, Udhëzim Nr. 22, Datë 24.09.2012 Per "Përcaktimin e Rregullave për Ruajtjen e Sigurisë të të Dhënave Personale të Përpunuara nga Subjektet Përpunuese të Vogla 1"

¹²⁶ Pika 8.a, Udhëzim Nr. 22, Datë 24.09.2012 Për "Përcaktimin e Rregullave për Ruajtjen e Sigurisë të të Dhënave Personale të Përpunuara nga Subjektet Përpunuese të Vogla".

¹²⁷ Pika 8.b, Udhëzim Nr. 22, Datë 24.09.2012 Për "Përcaktimin e Rregullave për Ruajtjen e Sigurisë të të Dhënave Personale të Përpunuara nga Subjektet Përpunuese të Vogla".

¹²⁸ Pika 8.c, Udhëzim Nr. 22, Datë 24.09.2012 PËr "Përcaktimin e Rregullave për Ruajtjen e Sigurisë të të Dhënave Personale të Përpunuara nga Subjektet Përpunuese të Vogla".

identifikuar, personi duhet të udhëzohet për ruajtjen e konfidencialitetit dhe duhet të ndalohet akses, menjëherë mbasi punonjësit nuk i kërkohet më të përpunojë të dhënat personale¹²⁹.

xiv. Siguria e të dhënave

Partitë politike duhet të marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar¹³⁰. Disa nga masat që duhet të marrin partitë politike për këtë qëllim janë: vendosja e një personi të caktuar që të jetë përgjegjës për sigurinë e të dhënave dhe për përditësimin e tyre, të drejtën e specialistit IT në kufizimin e numrit të personelit sipas procedurave të përshtatshme, kodimin me fjalëkalime të sistemeve kompjuterike, mbajtjen të fshehur të informacionit që ndodhet në ekranin e kompjuterëve tuaj dhe dosjeve manuale prej personave të paautorizuar, të cilët kërkojnë të njihen me të dhëna, etj¹³¹.

Të gjithë punëmarrësit të cilët kanë akses në të dhënat personale duhet të nënshkruajnë “Deklaratë të Konfidencialitetit”. Nënshkrimi i deklaratës së konfidencialitetit ka si qëllim që punëmarrësit të cilët kanë akses në të dhënat personale të kuptojnë qartë dhe drejtë detyrimet që ata kanë mbi përpunimin e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre dhe pas përfundimit të funksionit¹³². Për çdo punëmarrës që kryesisht përpunon të dhëna sensitive duhet të nënshkruajë “Deklaratën e konfidencialitetit”, sipas modelit të miratuar nga KDIMDP¹³³.

Kontrolluesi ka detyrim të përpunojë të dhënat personale për aq kohë sa ekziston qëllimi për të cilin janë grumbulluar dhe përpunuar dhe në momentin e përfundimit të qëllimit, duhet të realizojë shkatërrimin e tyre, në të kundërt, përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga kontrolluesi, në përputhje me parashikimet ligjore specifike dhe qëllimin e përpunimit të të dhënave¹³⁴. Gjithashtu, kontrolluesi ka detyrimin që të ndalojë menjëherë përpunimin e të dhënave personale në rast se ato përpunohen në kundërshtim me ligjin. Në këto raste, shkatërrohen në mënyrë të parikuperueshme të dhënat e mbledhura për subjektet e të dhënave dhe mbahen evidenca për shkatërrimin e tyre.

xv. Roli i KDIMDP

KDIMDP është organi publik kryesor i ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe marrjen e masave për parandalimin e cenimit të tyre. KDIMDP, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve kryen kontrollimin e përpunimit të të dhënave, në përputhje me ligjin, si dhe verifikimin nëse procesi është i ligjshëm.

¹²⁹ Pika 8. ç, Udhëzim Nr. 22, Datë 24.09.2012 Për "Përcaktimin e Rregullave për Ruajtjen e Sigurisë të të Dhënave Personale të Përpunuara nga Subjektet Përpunuese të Vogla"

¹³⁰ Neni 27 pika 1 i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

¹³¹ Pika 5, VendimNr.2, datë 10.3.2010 Për "Përcaktimin e Procedurave të Administrimit të Regjistrimit të të Dhënave, të Hedhjes së të Dhënave, të Përpunimit dhe Nxjerrjes së tyre".

¹³² Vendim Nr. 11, datë 16. 07 .2024 Për Kontrolluesin Hotel "Luna Magica" Lukovë, Pika 5; Neni 28 i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

¹³³ Pika 6, Vendim Nr. 6, datë 05.08.2013 Për Përcaktimin e Rregullave të Hollësishme për Sigurimin e të Dhënave Personale.

Në rastet kur konstaton përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale ai urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullimin. Në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit:

- Vendos masën e dënimit me gjobë në rastet kur shkelja përbën kundërvajtje administrative¹³⁵.
- Denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.
- Paraqet kallëzim penal kur shkelja përbën vepër penale¹³⁶.

xvi. Legjislacioni penal për zgjedhjet

Aktualisht, veprat penale në fushën e zgjedhjeve lidhen me korrupsionin aktiv dhe pasiv, dëmtimi i materialeve zgjedhore, shkelja e fshehtësisë në votim, votimi më shumë se një herë, etj, sipas neneve 325 - 332/a të kreut X “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve” të Kodit Penal.

Përpunimi në kundërshtim me ligjin e të dhënave personale për qëllime elektorale nuk gëzon një mbrojtje të veçantë nga ligji penal dhe në këtë rast do të zbatoheshin eventualisht dispozitat penale të përgjithshme si: përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike (neni 293/a i Kodit Penal), ndërhyrja në të dhënat ose sistemet kompjuterike (Nenet 293/b dhe 293/c të Kodit Penal), keqpërdorimi i pajisjeve (neni 293/ç i Kodit Penal), hyrja e paautorizuar kompjuterike (neni 192/b i Kodit Penal), mashtrimi kompjuterik (143/b i Kodit Penal), etj.

Në bazë të neneve 281 dhe 283 të Kodit të Procedurës Penale, procedimi penal mund të fillojë në bazë të kallëzimit penal i cili është i detyrueshëm të paraqitet nga nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, marrin dijeni për një vepër penale ose nga çdo person që ka marrë dijeni për një vepër penale dhe është i detyruar ta kallëzojë atë. Në përputhje me sa më sipër, ligji për mbrojtjen e të dhënave personale¹³⁷ ka parashikuar që KDIMDP bën kallëzimin përkatës për rastet që shkelja përbën vepër penale.

¹³⁵ Neni 39 i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar

¹³⁶ Neni 30 i i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

¹³⁷ Neni 30.2/1 i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) është institucion publik i Mbretërisë së Bashkuar që mbështet demokracinë në të gjithë botën. Me shtrirje ndërkombëtare, WFD punon me parlamentet, partitë politike, grupet e shoqërisë civile dhe me zgjedhjet që të ndihmojë t'i bëjë sistemet politike të shteteve më të drejta, më përfshirëse dhe llogaridhënëse.



www.wfd.org



[@WFD_Democracy](https://twitter.com/WFD_Democracy)



[@WestminsterFoundation](https://www.facebook.com/WestminsterFoundation)



Fondacioni Westminster për Demokraci është institucion ekzekutiv publik i mbështetur nga Zyra për Marrëdhëniet me Jashtë, Komunellthin dhe Zhvillimin.



British Embassy
Tirana